

Thani
Naqe

BIBLIOTEKA
SHTETIT

SH-32
N 24

Shtëpia
e përgjumur
tregime

814-32
1124

THANI
NAQE

SHTËPIA
E PËRGJUMUR

tregime



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

B I K U

Dëbora vazhdonte të binte pa pushim ditë e natë, duke krijuar një perde të gjatë pa mbarim përpara shpellës, hyrja e rrumbullakët e së cilës sa vinte e po zvogëlohej.

Katër partizanët e plagosur rëndë rrinin shtrirë mbi grumbujt e fletëve të thata të aheve, që kishin shtruar në patosin e gurtë të shpellës. Ata, me shpatullat mbështetur pas shkëmbit, mbanin vesh buçitjen e topave dhe të mortajave që dita-ditës dëgjoheshin më larg. Diku, nga thellësia e shpellës, vinte një gurgullimë e largët uji.

— Do të jetë ndonjë burim i nëndheshëm, — kishte thënë doktori ditën e parë për atë gurgullimë.

Dhe patjetër që do të ishte ndonjë burim i nëndheshëm në zemër të malit, se dhe uji ndihej gjithnjë e më qartë. Shushurima e stërkalave nxirrte herë pas here një tingull, sikur dikush fishkëllente gëzueshëm brenda malit shkëmbor.

Partizani i pestë, që ishte plagosur disi më lehtë, që mbështetur pas një shkëmbi të veshur me myshk. Kapotën e madhe ushtarake e kishte hedhur krahëve. Në njërin

krah ai mbante automatikun, ndërsa krahu i majtë, ku qe plagosur, i varej mbi gjoks lidhur me fashë. Kafshonte buzët, mbyllte përgjysmë ata sytë e tij kafe të qetë e tö shndritshëm dhe, si të gjithë, vështrimin e kishte tretur mbi bardhësinë e hyrjes së shpellës.

— Bik! — i thirri atij doktori.

— Urdhëro, doktor!

Dhe Biku brofi më këmbë. Ishte një djalosh rrëth të gjashtëmbëdhjetave, vetullzi e me fytyrë të rrumbullakët.

— Shko, mbush paguret me ujë, — e urdhëroi doktori.

— Sot do t'ju gatuaj një supë... misri...

Doktori trazoi zjarrin. Shkëndijat çanë rrugën përmes fjollave të tymit dhe u përplasën pas tavanit shkëmbor.

Të plagosurit ndoqën me sy rrugën që përshkuat këto shkëndija, duke lënë pas një mori vijash të zjarrita. Këto vija të zjarrita i pa edhe djaloshi që po mbante dy paguret në dorën e shëndoshë.

Aty, te hyrja e shpellës, rridhete një curril uji që si për shkëmbit, binte mbi dëborë dhe zhdukej aty për aty në masën e bardhë e të butë si pambuk. Djaloshi vendosi enët dhe uji filloj të rrjedhë në pagur duke tingëllirë.

Dëbora vazhdonte të binte. Biku e shihte fare mirë natyrën përballë, bardhësinë e pafund dhe majën e mprehtë të ndonjë bredhi të veçuar. Më tej nxinte një rrëpirë e thepisur përrroi, në formën e një shalli të zi që përshkohej nga një mori piklash të bardha si flutura.

«Si shalli i nënës! — mendoi Biku. — Eh, nuk të ngjet ai rrip toke si shalli i nënës ?!»

Paguri vazhdonte të mbushej, ndërsa partizani i vogël u mundua të përfytyronte nënën e tij të merakosur, mbështetur pas gardhit të oborrit...

«Kushedi sa éshtë bërë merak nëna! Kushedi ç'men-
ndon ajo tani! Me siguri ajo tani do të ketë hedhur pas
krahëve atë shallin e saj të madh dhe ka dalë te gardhi i
oborrit e vështron ... Një natë e éma kishte qarë sepse një
ballist e kishte gënjerë duke i thënë se partizanët ishin
vrrarë të gjithë. « Si éshtë e mundur? Po ato pushkë kush
i shkreh në male? Më marrsh të keqen o ballist! Djemtë
e nënës janë gjallë!»

Biku vështroi edhe njëherë nga ajo copë toke që nxinte
dhe vendosi nën curril pagurin tjetër.

«Si shalli i nënës! — përsëriti edhe njëherë djaloshi
dhe vështroi përsëri jashtë. — Po ti, nënë, mos u merakos
kaq shumë. Unë do të kthehem tek ti me lirinë».

Biku fërkoi dorën e plagosur dhe, duke vështruar,
rrudhi papritur ballin. Ç'po i shihnin sytë ashtu!? Përmes
perdes së dëborës, që vazhdonte të binte, ai dalloi ca figura
njerëzish që po çanin nëpër dëborë.

— Gjermanët! — u bëri zë shokëve në shpellë.

— Oh, erdhën prapë qenat!

— Bëhuni gati! — tha një nga partizanët e plagosur.
Ata nuk po heqin dorë nga kërkimi. Janë të sigurt se ne
të plagosurit ndodhemi në këtë pyll.

— Më duket se u ha koka këtyre leshverdhëve!

— Dita e gjashtë kjo që po mbajnë fshatin dhe pyllin
të rrethuar.

— Jo, prapë nuk do të na gjejnë dot! — tha doktori
duke mos ia ndarë sytë varganit që dredhonte nëpër dëbo-
rë. — Në pyll nuk duket asnjë gjurmë jona. Ato i mbuloi
dëbora që ra të nesërmen e asaj dite që ne u strehuam këtu.

Të plagosurit rrëmbyen armët dhe, duke u zvarritur,
zunë pozicionet.

«Jo, ata nuk do të na gjejnë dot! — tha përsëri dokto-
ri, por këtë radhë me vete, dhe shtrëngoi pushkën. — Ne

nuk duhet t'iu biem pa na rënë ata. Hyrja nuk dallohet, as nga larg dhe as nga afër. Vetëm ne i shohim... Bishat! Do të hanë kokën e tyre, po u afruan!»

Biku i pati futur karikatorin automatikut, mbajti frymën dhe ngjeshi syrin të shihte më mirë përmes një të çare të pиргут të dëborës

— Ikën!... poshtë, pas përroit, — tha duke fshirë gjunjët e mballosur me borë. — Ah, sikur të kishin ardhur edhe ca më pranë, pa do të shihnin si gjenden partizanët! Asnjë prej tyre nuk do të ikte i gjallë! I numërova: ishin njëzet gjermanë

— Sidoqoftë, ne jemi të rrëthuar — tha njëri nga të plagosurit dhe kolla i preu fjalën. Pak më vonë shtoi: — Ata duan që ne të vdesim urie ose të dorëzohemi... Ah, qena, qena! — shau në adresë të fashistëve, do të dorëzohemi mire ne, vetëm afrohuni, pa të shihni! Të shohim njëherë sa para ju bën lëkura!

— Vallë, kur do të kthehen tanët? — pyeti papritmas një nga të plagosurit. Kjo pyetje i mundonte të gjithë ditë e natë.

Ishte e treta herë që armiku kalonte afër partizanëve të plagosur. Përmes atij dimri të egër, gjermanë dhe ballistë ishin lëshuar në një operacion të madh kundër reparteve partizane me forca të shumta, për të asgjësuar njëherë e mire trimat e malit. Por si dukej, nuk po u shkonte plani mbarë.

Gjashtë partizanët tanë nuk i kishin parë ende flakët e shtëpive, vorbullat e zeza të tymit që lëshonin fshatrat e djegura. Brenda në shpellë dukej vetëm perdja e bardhë e dëborës. Ata, të rrëthuar siç qenë, prisnin të ktheheshin shokët dhe të bashkoheshin me ta.

Rrethimi vazhdonte. Vallë dhe sa kohë do të prisnin ashtu të rrëthuar?

— E gjeta! — thirri Biku me zë të lartë dhe duke rrëmbyer paguret vrapi drejt zjarrit.

— E gjeta doktor, e gjeta!

— Çfarë gjete, o trim? — ia bëri njëri nga të plagosurit. Lapsin që i humbi doktorit dje?

— Jo, jo, shokë. Gjeta mënyrën për të dalë që këtej!

— Duke flutuar? Ja që natyra nuk na ka bërë me krahë si shqiponjat dhe nuk fluturojmë dot!

— Doktor!

Doktori po mjekonte këmbën e njërit prej të plagosurve. Duke lidhur fashën, ktheu kokën dhe e vështroi partizanin e vogël në sy. Djaloshi i ishte ulur afër, në gjunjë dhe shtrëngonte ende në duar paguret bosh.

— Me qiklla!

— Me çfarë?

— Me qiklla, me qiklla!

Doktori mblođhi supet. Ç'ishin vallë këto qikllat? Ai për herë të parë e dëgjonte fjalën «qiklla».

Biku ktheu kokën dhe vështroi shokët e tjerë. Në shtë e të plagosurve shprehej habia: «ç'ishin vallë këto qikllat?»

— Biku u çua në këmbë dhe filloi t'u shpjegojë:

— Keni parë se si thuren koshat? Po?... Fundin e tyre e dini si është i thurur me degë? Njëlloj si një lesë e vogël...

— E, pastaj?...

Të plagosurit kishin ingritur kokën dhe vështronin djaloshin që lëvizte dorën në gjysmerrësirën e shpellës. Pastaj Biku u ul në gjunjë, shtriu dorën mbi hirin e ngrohtë dhe bëri një rreth duke shpjeguar formën e qikllave:

— Thuren me degëza tē holla, — tha. — Nga një qikell pér çdo këmbë. Lidhen pas këpucëve fort dhe dëbora tē mban pér bukuri.

— Eee!...

— Posi ore!...

— Vetém një gjurmë e lehtë, e lehtë, e rrumbullakët, sa qiklla, mbetet mbi dëborë...

— ... Që gjermanët tē na gjejnë me symbyllur!

— Jo shokë! Gjurma mbulohet menjëherë!

— Eshtë me rrezik more djalë!

— Jo xha Bato, nuk është hiç me rrezik! Dëbora e mbulon gjurmën porsa tē ngresh këmbën! E mbulon fët e fët!

Të plagosurit vështronin njëri-tjetrin tē çuditur. Ku u kujtua kështu papritur ky çamarrok pér tē nxjerrë një shpikje tē tillë?!

Të gjithë kishin kthyer kokën nga doktori. Prisnin mendimin e tij.

— Ne do tē durojmë edhe ndonjë ditë, — tha njëri nga tē plagosurit. — Kur kaluam këto ditë pa vënë gjë në gojë, durojmë edhe nesër... Mbase shokët kthehen...

Ai që foli kështu ishte ulur mbi një gur pranë zjarrit. I dukej fytyra e tretur me faqet futur thellë nënofulla dhe me mollëzat e kërcyera si dy bunga. Fërkonte pulpën e njërs këmbë dhe mbyllte sytë nga dhimbja.

— Po, njëri duhet tē dalë që këtej!... — tha më në fund doktori. — Ushqime nuk kemi... Edhe drutë u mbaruan... Zjarni tē largon urinë me ngrohtësinë e tij. Njëri nga ne duhet tē dalë. Duhet vrarë mendja pér këtë gjë... Na duhet jeta shokë. Lufta ende nuk ka mbaruar dhe atdheu pret shumë nga ne. Na duhet jeta... Mbase ka tē drejtë Biku?

— Me qiklla, doktor!

Sytë e Bikut shkreptinin. Djaloshi ende mbante këmbën mbi atë qikllën e tij imagjinare të vizatuar mbi hinin e zjarrit.

— Xha Bato, ma jep thikën!

Partizani i plagosur në pulpë nxori nga xhepi thi-kën dhe ia dha. Biku e vërtiti një grimë nëpër gishterinj dhe i menduar eci drejt hyrjes së bardhë. Qëndroi. Pesë-gjashtë hapa nën hyrjen e shpellës ishte një tumbë me lastarë të hollë ahishteje. Duke vështruar ato bisqë të holla, ngarkuar me borë, ndiente zemrën që i gufoftë në krahataror.

«Ka gati një metër dëborë — mendoi djaloshi. — Deri tek tumba e lastarëve më duhet të shkoj nën këtë jorgan të bardhë... Asnjë gjurmë...»

Mati me sy largësinë, mori drejtimin dhe sa hap e mylli sytë shkau në dëborë. Vendi ishte i pjerrët dhe trupi i Bikut shkiste poshtë duke çarë dëborën me këmbë.

«— I pjell mendja, — mendoi doktori duke vështruar tunelin nën dëborë. — Ka një imagjinatë të çuditshme për të krijuar... Kjo imagjinatë lindi për jetën... Të shohim ç'do të jenë këto qikllat!»

Filluan të dridhen lastarët. Dëbora u shkund nga degët e tyre dhe një bisk u zhduk nën dëborë. Doktori vë-shtronte se si pakësoshezin lastarët dhe padashur vuri buzën në gaz.

— Hiqini rripat! — tha doktori entuziast dhe eci mes të plagosurve. Papritur iu morën mendtë dhe, duke u lëkundur, ra.

«E kam nga dobësia», mendoi dhe u çua duke mbështetur pëllëmbët pas shkëmbit.

Njëri nga të plagosurit lidhi fort katër rripat dhe, duke u hequr zvarrë, kundërshtonte doktorin:

— Jam i fortë nga krahët doktor! Ti vetë nuk e ngjüt dot Bikun.

Lidhën një gur dhe rripi shkau poshtë.

— E, Bik!

— E, tërhiqeni!

Djaloshi kishte lidhur llastarët e ahishteve. Pas pak rripi shkau përsëri poshtë, por ishte e vështirë që doktori dhe njëri nga të plagosurit ta mbanin atë, forcë që i tërhiqte poshtë tunelit. Muskujt e dobësuar nga uria nuk i bindeshin vullnetit të tyre. Barkas dhe duke du ruar dhimbjet e plagëve, erdhën dhe të plagosunit e tjerë. Me duart që u dridheshin kapën rripin.

— Ngjitu, Bik!

— He! Po si të ngjitem? — u dëgjua zëri nëndëborë.

— Si të ngjitem me një dorë?... Tërhiqeni ju...

Pas shumë mundimesh u duk koka kaçurrele e Bikut e mbuluar me dëborë

Djaloshi kishte mërdhirë aq shumë, sa duart nuk i ndiente fare. Doktori ia mbështolli ato me një shami të lyer me alkool dhe ia fërkoi lehtë-lehtë. Një buzëqeshje fëminore dukej në buzët e mavjosura të partizanit të vogël.

Në zjarr po digjeshin drutë e fundit dhe flaka e tyre e kuqe përplasej në fytyrat e dobësuara. Ajo ndriçonte mjekrat e zeza të dy partizanëve, ballin e lartë të dy të tjerëve dhe sytë shprehës të doktorit.

Bikut i ishte lënduar plaga te bërryli dhe dhimbja po i therrte në gjithë trupin. Ndiente dorën e lehtë të doktorit që po i lidhët fashën dhe një djegësirë i ngacmonte stomakun dhe gjithë trupin duke u ngjitur lart nëpër fyt. Qëndroi ashtu shtrirë gjithë paraden. Të dukej sikur ato pak forca që i kishn ngelur atij djaloshi, tani kishin humbur nën dëborën e bardhë.

Të gjithë ata që ishin në shpellë filluan të mendonin se Biku nuk do të çohet dot. Mendonin kështu, por asnjëri nuk e tha një gjë të tillë. Edhe doktori nuk kishte thënë asnjë fjalë.

Pak më vonë në shpellë filluan përcartjet e para:

— Shokë... Ejani... Dërmojini gjermanët!... Bu-kë!
Sillni...

Duke parë gjëndjen e rëndë të shokëve, përcartjet e kllapitë e tyre, doktori mblođhi forcat, u ngrit dhe afroi pranë vetes lastarët e drejtë që i solli Biku. Mori disa në dorë, i kaloi nëpër gishtërinj duke i provuar sa të fortë ishin dhe i foli me një zë të ngrohtë djalit:

- Bik!
- Urdhëro, doktor!
- Si bëhen qikllat?
- Qikllat?...

Trupi i kapitur i djaloshit u drodh lehtë. Koka iu lëkund në të dy anët. Sytë i ndritën fort...

— Qikllat! Ah, po, qikllat!... Ja tani po çohem!

Biku u mbajt pas shkëmbit dhe u çua. Shtriu pëllëmbën përpara dhe lëvizi gishtërinjtë.

— Tani do t'i bëjë qikllat! — tha njëri.
— Po, do t'i bëj, — tha Biku duke vendosur mbi gjunjë një filiz të drejtë. Ia pastroi degëzat, por ishte e pamundur të punonte me një dorë. Të plagosurit vështronin me ngazëllim. Sytë e tyre ndiqnin lëvizjet e dorës së vetme ku ndriste tehu i thikës. Të gjithë e kuptuan se duheshin edhe duar të tjera. U mblođhën rrëth zjarrit dhe me gishtërinjtë e hollë plot damarë të zes filluan të ndihmonin Bikun.

— Ja, kështu bëhen qikllat! — tha Biku kur që mbaruar e para.

— Këto janë qikllat e shpëtimit! — tha doktori.

ninobnsip ëi mullit silloqja * nida bë më shëtig
lëshen por * M. Jol * qësiaq ëi ob dorën e nd
është atëbi kus hoxha shëllë ëi sig qënd më - kus

Dëbora vazhdonte si më parë. Perdja e gjatë e dëborës shtrihej përpara hyrjes së bardhë. Doktori hoqi nga zjarri një enë të vogël. Në fundin e asaj ene lëvrinin disa kokrra misri. Nga dhjetë kokrra për secilin! Doktori ndau lëngun me një lugë dhe kokrrat ua vuri të gjithëve në pëllëmbë. Nga dhjetë kokrra misër!

— Biku porsa kishte lidhur qikllat dhe po priste gati në këmbë.

— Do të nisesh?

Duart e të gjithëve u bashkuan. Në dorën e tij u grumbulluan gjithë kokrrat e misrit. Një ngrohtësi i përshkoi trupin.

— Merri Bik, — tha doktori. — Ti ke nevojë për to më shumë se ne. Je për rrugë!...

Biku nuk deshi, por ata ia futën me pahir në xhepin e kapotës. Biku nuk mund t'i hante ato kokrra në sy të shokëve të uritur. Ai e dinte fare mirë këtë.

Doktori hapi çantën dhe i dha dorezat e tij. Hoqi nga brezi edhe revolen dhe i tha:

— Merre këtë armë, Bik! Pushkën nuk ke si e merr... diktohesh.

— Ktheu shpejt Bik!

— Tako patjetër ndonjë njeri nga të njësitet të fshatit. Ata do të të ndihmojnë për çdo gjë!

— Na sill dhe lajme... Të fala i bëj nënës sate! I thuhaj se ne jemi gjallë dhe të mos dëgjojë se ç'thonë armiqtë!

Përpara se të shkiste nën tunelin e bardhë, doktori i vuri dorën në sup dhe e porositi:

— Hap sytë Bik! Mundohu të ecësh sa më shumë pas

përrenjve dhe sa më shumë mbi akull... Kujdes krahun!
Ktheu shpejt!

— Do të kthehem që sonte!

— Mundohu me çdo kusht të mos diktohesh. Qëlllo
vetëm atëhere kur të jesh i sigurt se të kanë diktuar.

— Unë i njoh mirë këto shtigje!

Biku i shtrëngoi dorën doktorit dhe shkau nën dëborë,
duke i përvendosur tē gjithë: «Vdekje fashizmit»!

Nga hyrja e shpellës shokët ndoqën rrugën e tij gjersa
ai u humbi nga sytë. Ecje me këmbët të hapura anash
dhe shumë i kujdeshëm.

— Ai do të kthehet sonte! — tha doktori.

SHTËPIA E PËRGJUMUR

Sipër ishte lëmi. Nën lëmë shtëpia e madhe, me çati të gjërë, mbuluar me plloça. Dritaret e shtëpisë ishin të zëna me hekura dhe përbrënda mbylleshin me kanate prej druri. Muret e larta që rrëthonin shtëpinë kishin lëshuar bark dhe të dukej sikur do të rrëzoheshin nga ditë në ditë. Shtëpia kishte një portë të madhe me dy kanate. Dërrasat e portës ishin të çara nga fundi dhe midis këtyre të çarave, po të ngjishje syrin, mund të shihje se ç'bëhej në oborr.

Një ditë, porta u mbyll dhe hapej vetëm kur dilte ndokush nga shtëpia. Mbaj mend se më parë në atë shtëpi fshatarët hynin pa u druajtur për të marrë ndonjë par-mendë ose lopatë, hynim edhe ne fëmijët për të luajtur në oborrin e gjërë. Po, që kur erdhi në këtë shtëpi një burri i panjohur (veshur i téri me shajak, me një kapelë të zezë në kokë, me fytyrë të egër dhe dinake, me një palë vetulla të kuqërrrema ku lëvrinin dy sy hakërrues), atje nuk shihje të hynin e të dilnin njerëzit si më parë.

— Thoshin se ai kishte banuar më parë në një fshat po-shtë në fushë. Kishte mjaft tokë dhe pasuri: kurse tani, ky burrë, që na kallte frikën ne fëmijëve, bëri të tijën edhe shtëpinë ku u vendos, bagëtinë, arën sipër në mal dhe atë tjetrën poshtë në luginë. Bëri të tijën dhe gruan e shtëpisë së cilës i kishte vdekur i shoqi në dhe të huaj.

Pra, ky njeri i vuri llozin portës, nuk afrohej fare me fshatarët dhe brenda mureve të lartë nuk ndihej në kishte jet apo jo.

Dimrit njëri nga oxhakët e shtëpisë nxirrte fjolla ty-mi. Kur zbardhët dëbora, shtëpia dukej më e madhe përmes bardhësisë, dritaret më të errëta. Ajo, si e përgjumur, heshtte ditë dhe natë. Në oborrin e kësaj shtëpie silljet rrotull një qen i egër që e solli ai burri me kapelë të zezë. Kushdo që kalonte përpara portës përcilëj nga hungërimat e Murros me trup të madh sa një ujk.

Ma kishte qejfi që atë qenin e egër ta ngacmoja dhe unë. Fusja shkopin tim prej thane në ndonjëren prej atyre të çarave të dërrasave dhe qeni në kulmin e zemërimit brente me hungërima shkopin tim të fortë prej bariu. Pastaj unë trokisja në portë. Dëgjoja që hapej dera e shtëpisë, tundeshin shkallët e vjetra, Murrua futej në qoshen e tij dhe pas pak ndiheshin hapat e dikujt në oborr.

Ishte Lina. Ajo m'i lëshonte çdo mëngjes dhitë përt'i kullotur. Tundte atë kokën e saj të vogël dhe më thoshte me zë të ulët:

— Bën ftohtë sot. Mos i vono shumë dhitë në mbrëmje!

Isha dy vjet më i madh se Lina. Bashkë ishim rritur dhe bashkë kishim luajtur në oborrin e gjerë. Verës hanim qershi, kumbulla, manaferra, ndiqnim fluturat në-për ara, ngjishnim kashtën në plevicë dhe, ashtu të lodhur

e tē djersitur, hidheshim mbi barin e thatë. Qëndronim fare pranë, duke na rrahur zemra fort nga lodhja.

— I-i! Sa shpejt tē nreh zemra ty! — më thoshte Lina dhe sytë i ndrisnin në gjysmerrësirën e plevicës.

Edhe unë vija dorën mbi gjoks dhe i thosha:

— Edhe ty Lina, njëlloj si mua tē rreh zemra!

— Na rreh kaq fort, se kemi ngrënë qershi tē kuqe, — thoshte ajo. — Nëna më ka thënë se lëngu i kuq i qershive dhe i kumbullave bëhet gjak.

— Ku e di nëna jote?

Por Lina, që shpeshherë thoshte tē tilla thënie tē së jëmës, kur e pyesja, çohej menjëherë dhe nuk më përgjigjej. Ne fillonim atëherë tē hapnim disa si tunele tē vogla në kashtë, futeshim aty ngjeshur pranë njëri-tjetrit dhe Lina e vogël më thoshte:

— Kur do tē më kapësh një xixëllonjë? Dua ta ngjis në ballë!

— I-i-i! — thërrisja unë në tunelin e kashtës. — Poty, Lina, tē ndrisin sytë si shkëndijë!

— Ua! Vërtet-o? Pse sytë e mi xixëllonja janë?

— Posi xixëllonja ndrisin! — dhe drejtoja dorën t'i prekja sytë e saj, por shpejt Lina shkiste nëpër tunelin e ngushtë dhe më dilte në anën tjetër tē plevicës.

Në njëren nga këto ditë vere, kur ne po luanim prapë në atë plevicën e mbushur me kashtë, Lina befas ia shkrepit tē qarit me tē madhe! I kishte hyrë një plehrë¹⁾ në sy. E kapa për dore dhe dolëm tē dy në oborr. Aty, ulur mbi një gur, ajo mbështeti kokën në gjunjët e mi, ndërsa lotët i rrëdhnin në fytyrën e përskuqur. Lotët e saj lagën dhe gishtat e mi dhe me mundim munda t'ia pastroj syrin me cepin e këmishës. Pastaj vrapuam në kroin aty

1) plehrë — grimcë e vogël kashte.

afër shtëpisë dhe, ndërsa Lina lante fytyrën me ujë, më thoshte:

— Unë do të bëhem vajzë e bukur! E di sa e bukur?!

Dhe Lina këtu heshtte se nuk e gjente dot se sa e bukur do të bëhej një ditë.


Edhe sot, kur i kujtoj këto fjalë, nuk e përcaktoj dot se sa e bukur donte të bëhej Lina. Pastaj duke krehur me gishta ata flokët e zinj, thoshte:

— Kështu më ka thënë nëna; unë do të bëhem vajzë e bukur dhe trime!

...dhe lodrat e fëmijërisë nuk kishin për të mbaruar, po të mos kishte ardhur ai burri i veshur me shajak të zi dhe me sy të egër...

Lina u rrit, u rrita dhe unë. Mbaruan lodrat e fëmijërisë, këngët, të qeshurat, ndërsa qershinë e preu me sëpatë ai burri. Disa vjet më vonë erdhën dhe ushtarë të një shteti të huaj me helmeta që digjnin shtëpi... dhe ne nuk hymë më në plevicën e mbushur me kashtë dhe bar. Duke shkuar vite në zemrën e Linës zuri vend një brengë e thellë. Buzëqeshja dhe zëri i saj i çiltër u mbyllën brenda mureve të larta, në dhomat e errëta të shtëpisë së përgjumur.

Tani unë isha i vetmi me të cilin Lina këmbente ndonjë fjalë. Bënim ndonjë bisedë të shkurtër, ashtu si mund të bisedojë një djalë shtatëmbëdhjetëvjeçar, siç ishte Lina. Bisedonim tek porta. Lina me kokë ulur, duart futur nën përparsë, ndërsa sytë e saj të zinj vështronin poshtë. Biseda ishte e shkurtër, aq kohë sa bagëtia kalonin nga porta nëpër oborr, gjer te hauri në fund të shtëpisë. Lina më vështronë vjedhurazi ne sy, ne shkurtë, ne portë natën e



mirë ulte prapë poshtë ata sytë e saj të bukur, shprehës, dhe mbyllte portën.

Një ditë pranvere unë i solla dhitë më shpejt se ditët e tjera. Afër fshatit krisi pushka, gjëmimet e topave tundën vendin, dhitë u trembën, çanë përmes korijes dhe vrapin e mbajtën në fshat.

Lina doli si ngaherë dhe më hapi portën, e trembur. Bagëtia kaluan nëpër oborr, por njëra nga dhitë ngeli pas dhe mezi ecte. Këmbën e pasme e hiqte zvarrë.

— O-bo-bo! Çalon Larushka!

— Do t'i ketë hyrë ndonjë kleçkë, — i thashë. — Prit ta shohim njëherë.

Ishte hera e parë që pas disa vjetësh hyja në atë oborr. Lina kapi për brirësh dhinë që çalonte dhe belbëzoi e trembur:

— E paska këmbën të enjtur. Sikur të vijë xhaxhai?... Sa dëgjova këto fjalë, ashtu siç qeshë ulur në gjunjë pranë dhisë, ngrita kokën dhe brofa në këmbë

Prania e atij njeriu të egër dhe zemërlig më kallte frikën.

— Nuk është në shtëpi ?, — e pyeta.

— Po bën javën që nuk është kthyer nga qyteti — tha Lina me sy të trembur dhe të mbushur me lot. — Tani, në pranverë, ikën dhe humbet me ditë të tëra. Se ku vete, nuk na tregon... Edhe me mua sillet shumë keq...

— Ai nuk është njeri i mirë, — fola unë, duke prekur me gishta këmbën e dhisë ku e ënjtura kishte marrë këllkun dhe një pjesë të barkut.

— Dhinë e ka kafshuar gjarpëri — i thashë.

— Po tani si të bëjmë ? Ajo do të ngordhë... E mje ra unë ç'më pret kur të kthehet ai...

Këtu Lina ngeci. Kafshoi buzën, e penduar për ato

që tha, dhe gati sa nuk ia plasi vajit. Kur i vura dorën në sup, ajo u drodh. Dhia i shpëtoi nga duart dhe hyri në plevicë. E qetësova duke i thënë:

— Nuk ka ndonjë rrezik Lina. Dhinë do ta shëroj unë. Ti bëj gati fenerin. Unë po shkoj të marr një dorë gjethje lajthishteje dhe disa gjemba murrizi.

Dola me vrap nga oborri dhe pas pak u ndodha në korije. Mbusha krahun me degë lajthish e me disa gjemba të hollë murrizi që më çorrën duart, dhe u ktheva me një frymë. Kalova obornin pa u ndier. Dritaret c shtëpisë nxinin. Asnjë dritë, asnjë zë. Shtëpia tani natën dukej si një shtëpi e përgjumur.

— Lina! Lina!

— Një përgjigje e mbytur erdhi që nga plevica. Pra Lina ishte aty. Ajo kishte varur fenerin në mur dhc po priste.

— Duhct gjë tjetër? — më pyeti.

— Po, duhet një enë me ujë të ftohtë!

E shtriva dhinë mbi patos, ndërsa ajo përpëlitez në duart c mia që të çohej. Lina solli ujë. I lava dhisë, vendin e enjtur, mora gjembat e murrizit dhe fillova t'i shpoj me të shpejtë lëkurën e fryrë. Kjo punë vazhdoi më se gjysmë ore. Më në fund i fërkova vendin e shpuar me fletët e lajthisë dhe e bashkova me dhitë e tjera.

Lina mori fenerim dhe ne dolëm nga plevica. Ishte bërë natë. Nga jugu frynte fllad i lehtë dhe i ngrohtë. Hëna kishte dalë mbi majën e malit dhe vetëm një cep i saj ndriste, kurse reja varej deri poshtë duke i prerë ndriçimin.

— Lina !

Ajo qëndroi. Feneri që mbante në dorë ndriste pas tokës me një dritë të zbehtë që dridhej. Lina u kthyte nga unë, por fytyrën e saj nuk e shihja dot.

— Ti, e ke shumë frikë atë njeri?

- Cilin? — pyeti ajo mc zë të mckur.
- Xhaxhanë.
- Xhaxhanë?
- Po. Ai është njeri i keq... — shtova.
- Ashtu është, — tha Lina. — Unë nuk i kam thënë asnjëherë atij «baba».

— Atij njeriu nuk i takon t'i thuash «baba»!

Kishim qëndruar në mes të oborrit. Ishte errësirë e madhe dhe drita e dobët e fenerit përplasej pas këmbëve tonë. Në qoshe të murit, ndihej hungërima e Murros plak. Ndonjë xixëllonjë çante errësirën. Njëra nga ato kaloi afër nesh dhe unë ngrita dorën dhe e kapa.

— Mere Lina! Një xixëllonjë!

Lina lëshoi fenerin në tokë dhe zgjati dorën të marrë xixëllonjën. Gishtat e saj të hollë shkanë mbi pëllëmbën time të ashpër derisa kapën xixëllonjën.

— Sa i mirë je ti!, — belbëzoi. — Ja, kështu si ti është dhe im vëlla!

— Ka ardhur ndonjëherë vëllai të të shohë tanë së shpejti?

— Ka ardhur. Vjen natën dhe ikën përsëri natën. Vjen kur nuk është «ai».

— Pse «ai», nuk do që vëllai yt të jetë partizan?

— Nuk ka dashur kurrë. Një natë u grindën aq shumë, sa për pak do të ishin vrarë me njëri-tjetrin.

Lina kokulur, mbante ende në dorë xixëllonjën që ecte midis gishtave dhe merrte frymë me zor.

— Vëllai e shau dhe i tha se edhe nënën «ai» e bëri të vdesë.

— Ai nuk është njeri i mirë!

— Është bashkuar me ata të Ballit. Ai është bërë ballist, — tha Lina dhe mori fenerin në dorë. Vëllai i tha se plumbin do ta merrte nga dora e tij!

- Këto i di dhe unë — i thashë.
— Çfarë di ti?
— Ja, që ai është bashkuar me ballistët. Njerëz të tillë si ai janë bërë tradhtarë.

Lina heshti për një çast, pastaj foli:

- Vëllai erdhi parmbërëmë. Ishte shumë i zemëruar dhe diçka e mundonte...

Lina nguroi të vazhdojë më tej. Edhe unë nuk e pyeta më. Hapa portën e rëndë dhe dola në rrugë. Nata ishte e errët dhe qelli çuhej herë pas herë nga ndonjë shkrep-timë e largët.

— Natën e mirë, Lina!

— Natën e mirë!

Atë natë nuk më zinte gjumi për asnjë çast. Shkrep-timat sa vinin dhe po shtoheshin, por gjëmimet ende nuk kishin filluar. Xixëllonja të shumta endeshin përpara dritares sime. Gjithë atë natë renda pas tyre...



Sipër ishte lëmi. Nën lëmë shtëpia e përgjumur. Më pëlqente shumë të rrija mbi çakëllin e lartë të atij lëmi, një çakell i mbuluar me myshk, nga ku fshati dukej si në pëllimbë të dorës.

Në shtëpinë e përgjumur atë natë kishte njerëz. Di-çka e kundërt me shtëpitë e tjera të fshatit. Ndërsa të gjithë u kishin vënë llozin portave, atë natë shtëpia e përgjumur kishte hapur të dy kanatet e portës, nga ku hynin e dilnin njerëz me qeleshe, ushtarë me helmeta dhe automati-kë në sup. Oborri i gjërë gumëzhinte nga hingëllima ku-ajsh, kakarisje pulash, blegërima bagëtish të plaçkitura. Në atë oborr ishin dhe dy dhitë e mia, aty ishte dhe gjig-

thë bagëtia e fshatit. Dengje me plaçka kishte kudo në oborr.

Tej, nga mëhallat tjetër e fshatit, dy shtëpi nxirrin flakë. Flakët çoheshin lart në quellë dhe drita e tyre godiste muret e shtëpisë së përgjumur.

Të gjitha këto i shihja që nga çakëlli i lartë. Papritur errësirën e natës e çau kënga e bilbilit. Veshi im prej bariu, i stërvitur me gjithë këngët e zogjve, dalloj gabimin e kësaj kënge. Pas pak një hije doli nga porta e shtëpisë së përgjumur dhe po vinte drejt lëmit. E njoha, ishte Lina. Ajo u takua me të vëllanë aty, afër meje, matanë gardhit, dhe i tha gati më të qarë:

— Shtëpia është mbushur plot me ballistë dhe gjermanë! «Ai» u ka shtruar sofrën atyre!

Vëllai i hodhi dorën në qafë, rregulloi kapelen me yll dhe bëri shenjë me dorë. Gardhin e kapërcyen edhe disa partizanë të tjerë.

— Hyr brenda, — i tha Linës, — dhe hapi të gjitha kanatat e dritat e pasme. Ti mos u tremb. Jemi ne këtu. Kur të çlironjmë Shqipërinë, do të ngremë një shtëpi të re dhe të bukur. Shiko tañi motë. Ne po të presim këtu!

U hoqa me kujdes prapa, zura vend pas gurëve dhë nxora nga xhepi bombën e vetme që mbaja prej kohësh.

Sipër nga lëmi u derdh breshëria e parë e automatiskut. Pas kësaj breshërie disa gjëmime pasuan njëra-tjetërën brenda në shtëpi. Midis tyre dhe gjëmimi im.

Catia e madhe e mbuluar me plloça u fundos poshtë.

Vëlla e motër të zënë për dore vraponin në udhën e malit.

Edhe unë u nisa. Nuk kisha si të ndahesha prej tyre.

K O M B A J N E R I

— Në atë dhomë flenë dhe dy kombajnerë, — më tha plaku, kur po ngjitnim shkallët e drunjta të hotelit të fshatit. Duke mbajtur ende në dorë fshesën, ai ngjitej përpara meje me një hap aq të rëndë, sa që kërcisinin dërrasat. Hapi derën, ndezi dritën dhe shtoi:

— Ja, ai shtrati aty është bosh. Janë xhevahirë djem! Nuk do të mërzitesh fare. The se do rrish një muaj në fshatin tonë? Me ç'punë merresh?

— Piktör.

— Aha, piktör!... Të them të drejtën kanë ardhur çdo vit këtu piktörë, por sa vinim, iknin. Iknin ore, se ç'shkaravitin në ca letra dhe... Po ti e paske ndryshe punën.

Kishte një zë të ngjirur dhe kollitej herë pas here. I dhashë një cigare dhe ai e vuri menjëherë në vesh. Kontrolloi dritaren, drejtoi perden dhe më tha se në katin poshtë ishte mensa. Po të kisha nevojë për të ngrënë darkë, mund të porositja. Por unë i thashë se darkën e kisha ngrënë para një ore në rrugë e sipër. Atëherë plaku më uroi natën e mirë dhe zbriti shkallët me hapin e tij të rëndë.

Isha lodhur nga rruga. U zhvesha dhe rashë të flija. E dija që gjumi nuk do të më kapte shpejt. Kjo më ndodh-te gjithnjë kur ndodhesha në ndonjë vend të panjohur. Është e vështirë për ata që janë mësuar të flenë gjithnjë në të njëjtin shtrat. Ndryshe qëndron puna me të tjerë që i zë gjumi në çdo vend. Për ta çdo shtrat është i njëjtë me shtratin që janë mësuar dhe nuk u bën përshtypje. Të them të drejtën, derisa mbarova shkollën, rrallëherë kisha fjetur larg shtëpisë sime. Por njeniu në jetë mësohet me çdo gjë dhe më vonë nuk i bën shumë përshtypje se ku fle, mjaftron të shtrihet e të çlodhet.

Ashtu siç isha shtrirë në shtrat, fillova të përfytyroj fshatin, shtëpinë prej guri, pyllin, mullirin me kadet prej dru lisi te korija, kalanë e vjetër prej nga dukej lugina si në pëllëmbë të dorës. Të gjitha këto i shkoja ndër mend duke përfytyruar edhe tablotë e ardhshme. Fshati ende nuk kishte rënë në gjumë. Zhurma e një autokambajne vinte deri tek unë, duke u dalluar nga zhurmat e tjera. Atë çast mendova se fshati ku kisha vajtur, nuk ishte i qetë. Përveç zhurmave të punës atje ndihej edhe oshëtima e lomit, i cili zbriste nga mali dhe kallonte përmes fshatit me gurgullimë. Në një çast autokombajna heshtि pa pritur.

«Ata duhet të kthehen tani», mendova për të dy kombajnerët.

Në kohën që pushuan kombajnat, nuk di, por mua m'u duk sikur veshi më kapi tingujt e një fizarmonike që binte diku aty afër. Menjëherë mendova se diku, afër fshatit do të kishte ndonjë dasmë a mbrëmje vallëzimi, ose ndonjë komshi kishte hapur radion deri në fund.

Pak më vonë u dëgjuan hapa në rrugë, uji që u derdh nga një çezmë, hingëllima e një kali dhe një knismë e thatë sikur të ishte thyer ndonjë xham. Të gjitha këto u pasuan nga e qeshura e një vajze.

- E theve kanën, moj bijë?
- I ka dasma këto!
- Po përse qesh kështu?
- Më qeshet xha Koli!
- Epo, vajzat kështu qeshin, si laraskat?.

Përsëri u dëgjua e qeshura e vajzës që kishte thyer kanën me ujë tek çezma e që po largohej me nxitim.

Dikush vrapoi në korridorin poshtë dhe filloi të ngjittë shkallët me nxitim. Dërrast nën peshën e hapit të tij, kërcisin. Dera e dhomës u hap me kujdes dhe ai që hyri ndezi një shkrepëse. Siç duket, e dinte që në dhomë ndodhej dhe një tjetër dhe nuk e hapi dritën se mos më zgjonte ndezi një cigare dhe u ul në cep të shtratit.

Tingujt e fizarmonikës u dëgjuan më mirë. Ai që ishte ulur te shtrati u nder mbi përvaz të drithares. Tingujt e fizarmonikës u mbytën nga kënga që buçiti papritur:

- Përse të rrit mamaja ty,
- Përse të zbukuron kaq shumë ?

U kollit pa dashur dhe ktheu kokën nga unë i trembur.

- Erdhe ? — i fola.
 - Hoqi cigaren nga goja dhe u përgjigj:
 - Më fal se të zgjova... Flije ?
 - Jo.
 - Xha Koli më tha se re të flije, prandaj nuk të fol la kur hyra.
 - Nuk po më zë gjumi, — i thashë.
 - Hoteli është i qetë — tha ai — por sonte, këtu afër, po bëhet një dasmë.
 - Dëgjohen tingujt e fizarmonikës.
- Ai erdhi pranë meje dhe më zgjati dorën. Era e naf-tës më ra në hundë sapo u ul. Dukej shumë i lodhur dhe pyetjeve të mia u përgjigjej me gjysmë zëri.

— Sot jam lodhur shumë — tha ai. — Por ngadonjëherë njeriu nuk duhet të kursejë asgjë. Është fushatë dhe gruri ndër ara pret të korret. Si ta lësh këtë grurë pa korru në një kohë kaq të mirë?!

— Ke shok tjetër?

— Iku sot në mëngjes... E priste e fejuara. Shoku për shokun shpesh sakrifikon. Veçse është djalë i mirë dhe punëtor.

— Kur ke shok të mirë edhe puna shkon mirë. Me korrjet gjer ku jeni?

— Mbaruam sot — tha kombajneri. — Nesër iki në sektorin tjetër, por për dreq, më ndodhi një defekt në kombanjë. Më mori zjarri motori. E fikëm, po ç'e do? Flaka ishte e fuqishme dhe dogji mjaft tela.

— Sa keq...

— Më ka ndodhur dhe një herë tjetër kështu.

Kombajneri u çua dhe shkoi prapë te dritarja. E flaku cigaretën jashtë dhe foli:

E dëgjon si kërcet dasma?

— Ata që dashurojnë, një ditë do bëjnë edhe dasmën, — ia ktheva. — Të kanë ftuar ty në dasmë?

— Po. Ku e di ti?

— Kot. Më vajti mendja.

Kombajneri u shtri në shtratin e tij dhe ndezi një cigare tjetër. E pashë që ishte i Jodhur dhe nuk desha t'i flisja. Ai duhej të flinte që të ishte të nesërmen i çlodhur për punë.

— I martuar je? — më pyeti papritur.

— Beqar — i thashë.

— Ke ndonjë të dashur?

— Kam një shoqe në qytet, por ende nuk jemi fejuar...

— Qenkemi njëllloj të dy, — tha ai. — Edhe unë...

U çua prapë dhe shkoi te dritarja.

«Përse nuk përgatitet për në dasmë? — mendova.

— E kanë ftuar dhe nuk do të shkojë? Përse nuk e nxë vendi, po çohet herë pas here te dritarja?»

— Nuk paske gjumë, — i thashë.

— Pres centralistin e fshatit, — tha ai, dhe buzë-qeshi. — Më premtoi të më sjellë ca tela për të rregulluar lidhjet e motomit.

Ne po bisedonim kështu në errësirë dhe nuk ishim kujtuar asnjeri për të ndezur dritën.

— Ke kohë që punon kësaj ane?

— Unë vij çdo verë këtu, — tha ai. — Vetë jam myzeqar. Mbarojmë së korruri Myzeqenë dhe fillojmë shtegtimin për në Jug dhe në Veri. Këtu, në këtë fshat, vij çdo vit.

Shkallët e hotelit kërcitën prapë. Kombajneri hapi dritën dhe brenda në dhomë hyri centralisti që lëshoi mbi dysheme një tufë me tela.

Kombajneri ishte një djalosh fytyrërrumbullak, zeshkan, si të gjithë kombajnerët. Kishte veshur një këmishë me mëngë të shkurtra, e kishte të zbërthyer përpara dhe i dukeshin gjoksi dhe supet e gjera. Mbi flokët kaçurtela i kishin mbetur akoma pluhuri dhe byku i kashtës.

— Të mirë janë telat? — pyeti centralisti.

— Më të mirë s'ke ku gjen. Janë të mirë për aty ku më duhen mua, — tha kombajneri duke i mbledhur telat vilar.

— Nuk po vjen në dasmë ti?

— Më kanë ftuar, — tha kombajneri, por, dhe mund të mos vij. Dua të fle. Nesër pa lindur dielli të pres te autokombajna.

— Ashtu e lëmë, — tha centralisti.

— Unë nuk i dal nga fjala kryetarit, — shtoi komba-

jneri duke nxjerrë nga valixhja e tij pincat, një numër çelësash dhe një çekic. — Nesër në orën nëntë duhet të jemi patjetër në vendin e punës. Është gati një orë larg që këtej.

— Me gjithë mend e ke ?


— Nuk ecën dot më shpejt kombajna, se është dhe rruga e keqe dhe ka gropë. — Kombajneri u mbush me frymë thellë, vështroi nga unë, tundi kokën i shqetësuar dhe vazhdoi : — Po, po, rruga është e keqe. Por edhe fjalën nuk ia ha dot kryetarit. Më njojin mirë mua fshatarët. Na presin punëtorët, brigada e tërë, ma pret dhe gruri.

— Pret dhe... — foli centralisti duke e lënë fjalën pa mbaruar.

— Le të presë. Në dasmë nuk vij dot sonte.

— Pret dhe... — pëshpëriti prapë centralisti i fshatit duke ngritur lart ato vetullat e tij kaleshe.

Centralisti iku dhe ne mbetëm prapë të dy. Kombajneri u shtri në shtrat pa u zhveshur, duke më thënë «natën e mirë».



Dikush e hapi derën e dhomës. Hapa sytë. Ishte plaku i hotelit, xha Kola. Ai vështroi nga unë i çuditur duke mbledhur supet. Vështroi orën e xhepit dhe duke bërë njëherë «bah!» me veten e tij, m'u drejtua mua, kur më pa që isha zgjuar:

— Mirëmëngjes piktor... Në dasmë ka shkuar? — më pyeti duke treguar me dorë shtratin bosh të kombajnerit:

— Jo, ai nuk shkoi mbrëmë në dasmë — i thashë.

— Mbështetës ka shkuar tek autokombajna për të rregulluar defektin e mbrëmshëm.

— Unë për të erdha — tha plaku duke mbledhur sупет. — Më tha mbrëmë që të vija ta zgjoja në orën pesë, në mëngjes, kurse ai paska ikur. Shkallët e hotelit u drodhën prapë. Dikush i ngjiti ato me nxitim. Ishte centralisti.

— Paska ikur? — pyeti ai me një frymë.

— Do të ketë ikur shumë herët, — tha xha Koli, — se paska marrë dhe fenerin tim që e kisha lënë te shkallët.

Porsa dolën të dy, duke më kërkuar të falur që më zgjuan, u dëgjua papritur buçitja e kombajnës.

— Paska punuar gjithë natën qerratai! — tha xha Koli duke qeshur dhe futi kokën përsëri në derën që nuk ishte mbyllur plotësisht.

U çova dhe unë. Pak kohë më vonë mora në duar mjetet e punës dhe eca andej nga vinte zhurma e auto-kombajnës.

I BIRI

Katër veta po zbrisnin në të tatëpjetën e madhe të Bigllës. Nxitonin përmes dëborës nëpër gryka e përrën që uturinin nga një erë e fortë, e cila e ngrinte dëborën e imët nga toka dhe ua pérplaste në fytyrë.

Ndër të katër, njëri ëcete pérpara, tjetri prapa, që të dy me nga një fener në dorë, kurse dy të tjera që ishin në mes mbanin në krahë një të sëmurë të shtrirë mbi vig. Të sëmurin e kishin mbështjellë me batanije, i kishin hedhur përsipër edhe një mushama, e cila rrëshqiste dhe ai që vinte pas me fener kohë më kohë e ngrinte dhe ia hidhte të sëmurtit.

Kishin dy orë që udhëtonin përmes tufanit: dy orë që çanin dëborën e trashë gjer pérmbi gju. Era e tërbuar e atij janari të egër pérplasej në gjoksin e udhëtarëve që zbrisnin nga maja e malit Moravë dhe ua bënte shumë të vështirë frymëmarrjen. Ora po shkonte një pas mesnate, kur pérpara atyre të katërve shkrepit një dritë. Ishte një dritë e dobët që mezi shquhej si një bukurrezë.

— Ja fshati! — tha ai që ecte në krye dhe qëndroi.

— E, sa mban që këtu? — pyeti ai që mbante vigun përpara.

— Për një çerek ore mbërrimë — shpjegoi i pari dhe kapi vigun. — Të shohim në do ta ndezë dot Sotiri makinën...

— E njeh mirë ti shoferin?

— E njoh. Bile më ka mbajtur njëherë për darkë.

— Jo ore!

Ecnin njëri pas tjetrit, por tani që përpara tyre dukej ajo dritë, çapet bëheshin më të gjata dhe më të shpejta.

*

* * *

— Nënë! Më duket se po trokasın në portë!

Nëna, që flinte në shtratin tjetër të dhomës, nuk e ndjeu zërin e të birit.

— Moj nënë!

— Hë, more bir!..

— Po trokasın në portë!

— Jo bir, jo. Troket era pas xhamit të dritares!

Kujtimi u mbulua më mirë me velenxë dhe u kthyen në anën tjetër.

Netët e dimrit janë të gjata. Shpesh njerëzit, duke qëndruar pranë zjarrit, dremisin, dhe pastaj u del gjumi natën, ndërsa në mëngjes ngrihen pa zbardhur ende dita. Edhe Kujtimit, që ishte kthyer në fshatin e tij me pushimet e dimrit, i doli gjumi natën dhe, duke u vënë veshin fishkëllimave të erës, mendonte për shokët dhe lodrat me dëborë.

— Moj nënë, po trokasin në portë!

Nëna u çua. Ndezi dritën e dhomës, hodhi pallton pas krahëve dhe doli.

— Kush është?

— Hape, hape Sotiricë, jam unë Faiku!

Kujtimi dëgjoi kërcitjen e dëborës nën këmbët e atyre që ecnin në oborr.

— U, djemtë e nënës! Ç'ju ka gjetur kështu në mes të këtij kiameti?

Cizmet kërcitën në dërrasat e korridorit, ndërsa një rrymë e ftohtë ajri hyri në dhomën e gjumit dhe u përplas pas dritares. Perdet u drodhën, nja dy kartolina të Vtitit të Ri shkanë pas murit, ndërsa tapitaja me luanët u çua lart duke valëzuar.

— Këtu, këtu, në dhomë, ka akoma zjarr, — thoshte nëna. — Të shkretin djalë ç'e paska gjetur!

Në dhomë hynë katër ushtarë. Kapotat dhe kapelat u ishin mbuluar me dëborë. Lëshuan vigun mbi dysheme dhe zbuluan të sëmurin. Edhe ai ishte ushtar si ata. Mbledhur sa një grusht nga dhimbja, me nofulla shtrënguar, hapi sytë e lodhur prej dhimbjes dhe tënkoi lehtë.

Kujtimi po vishej me të shpejtë kur dëgjoi njërin nga ushtarët që po i thoshte nënës:

— E ka zënë një dhimbje në bark para dy ditësh, por mendoi se do t'i kalonte. «Do më kalojë, — thoshte. — Kështu më zë shpesh stomaku». Po do ti, nënë Sotiricë, që në mbrëmje i filluan përsëri dhimbjet, më të forta...

Ushtari heshti dhe vështroi shokët.

— Nënë Sotiricë, ai është i sëmurë rëndë, megjithëse duron shumë, — tha njëri nga shokët.

— O, e mjera unë! Po Sotiri që nuk është?!

— Si ?! Nuk është?!

Gjëmoi në dhomë zëri i ushtarëve që shprehën një dhimbje të madhe për shokun.

— Ai është në rrezik — belbëzoi Faiku dhe nxori nga xhepi paketën e cigareve.

Ushtarit i kishin ngrirë durat dhe nuk e kapte dot fijen e shkrepëses. Kujtimi mori me mashë një thëngjill të ndezur nga soba. Ndërsa ushtari thithë tymin, Kujtimi, djaloshi 15-vjeçar, e vështroi në sy dhe i tha:

— Babai ka shkuar në Korçë që dje dhe nuk është kthyer.

Ka shkuar në mbledhjen e shoferëve të dalluar.

— Po makinën?

— Makina është këtu në fshat.

— Sami! — i tha Faiku njërit nga ushtarët që ende po rrinte te dera. — Me vrap te telefoni! Kërko urgjent...

— Telefon është i prishur... Era...

Megjithatë ushtar Samiu doli dhe hapat e tij kërcitën në rrugë.

— Edhe linja jonë telefonike e repartit ishte prishur...

Frym një erë e marrë që mezi kemi zbritur deri këtu.

— Dimër, o bijtë e nënës! Po ku ndodhi kjo gjëmë sonte që nuk është im shoq? Kujtim!

— Urdhëro nënë?

— Shko thirr infermieren! Vish çizmet e babait dhe vrap.

I sëmuri nuk ndihej. Fytyra e zverdhur dukej sikur flinte, ndërsa në nofullat e shtrënguara nuk lëvizte asnjë muskul.

— I humbi ndjenjat!... E treta herë kjo!...

Nëna u ul në kryet e të sëmurit dhe filloj t'i fërkojë ballin. Kaçurrelat e lagura përdridheshin pas gishtave të nënës, dhjetëra kujtime shkisnin në mendjen e asaj nënë

fshatare. Shkisnin duart e saj në ballin e të sëmurit, sikur çanin rrugët e atyre viteve.

...Ishte stuhi lufte dhe stuhi dimri. Nënët ngjiteshin drejt malit përpjetë. Dëbora dhe të ftohtët nuk i mposhtnin, sepse luftonin për jetën e bijve të tyre që kacafyeshin me pushtuesit gjermanë e me reaksionarët vendas. Pesha e torbave me bukë në shpinë, me fanella e çorape, nuk i përkulte, se ato do t'u shpëtonin jetën fëmijëve të tyre që luftonin ditë e natë jashtë, në dëborë e nëngrica...

Por nuk ishte koha të përhumbej në kujtime të tilla. Prandaj u çua, doli nga dhoma, vajti mori një krahë dru, ia hodhi zjarrit dhe në korridor takoi Faikun akoma më të shqetësuar.

— Si është, bir, i sëmuri?

— Për dy tri orë duhet të jetë medoemos në duart e doktorit! Kështu mendoj unë, po nuk e di!...

— Bir, bir! — thirri nëna për të sëmuran, duke pleksur e shpleksur duart në kraharor.

Në oborr u dëgjuan përsëri hapa. Ishin infermierja, ushtar Samiu dhe Kujtimi.

— Gjendja është shumë e rëndë, — tha infermierja.

— Ndihmë mund t'i jepet vetëm në spital nga mjekët, madje, sipas mendimit tim, për të duhet mjeku specialist.

Kujtimin nuk e mbante vendi. Të tjerët kishin hyrë të gjithë brenda tek i sëmuri, kurse ai qëndroi në korridor i menduar. Befas u shkund sikur t'u ishte kujtar diçka. Ngjiti shkallët e drunjta dhe hyri në një dhomë të katit të sipërm. Vështroi pantallonat e të atit dhe ndjeu erën e benzinës në hundë. Futi duart në xhepa dhe gjeti çelësat e makinës të lidhur në një zinxhir të verdhë. I peshoi në dorë duke i tringëllirë dhe iu dukën tepër të

rëndë. I vështroi një grimë në heshtje, rrudhi ballin i menduar dhe veshët i buçitën nga një zhurmë e njohur motori...

* * *

«— Shiko more djalë mësimet! Ç'të duhet ty shoferillëku! — i thoshte i ati, sa herë që Kujtimi futej në kabinën e zisit të kooperativës. Kujtimi e pyeste pa u lodhur për çdo gjë dhe i ati ia kthente:

— Shiko të na nderosh në shkollë, atë punë ke ti!

Sotiri e ngacmonte të birin dhe, duke e vështruar në-përmjet pasqyrës së vogël, vinte buzën në gaz dhe thoshte me vete:

«S'ka ç'i bën, ja që i pëlqeijnë hekurat! Kërkon të bëhet shofer, por është ende i vogël...»

Pastaj kujtonte të shoqen. Eh, sa u grind me të përt'i vënë emrin këtij djali! Nuk e pëlqente e shoqja emrin «Kujtim». Por Sotiri kishte vendosur që më parë për emrin e djalit. Ai donte t'i vinte emrin e një shokut të tij në ushtri. Kur kryente shërbimin ushtarak, në një postë të largët kufitare, iu vra një shok. U vra një natë vere në krye të detyrës. Ai quhej Kujtim.

«Pret djalë të lindë? — e kishte pyetur ai në çastet e fundit. — Po qe djalë ... Sotir, vëri emrin tim!»...

...Dhe babai zbriste nga makina. Kujtimi i vogël menjëherë zinte vendim e tet dhe shtrëngonte timonin. Shkelte pedalin dhe makina uturinte. Ekte disa metra, por, befas, çamaroku shkelte frenat dhe koka mend i zinte te xhami.

— Mistrec! Edhe njëherë nuk të marr në makinë! More vesh? Përse trazon? Përse? Që të na hedhësh ndonjë ditë në hendek?

— Unë dua të bëhem shofer! — thoshte Kujtimi 15-vjeçar dhe fërkonte faqen e skuqur nga shpulla e babait.

— Mbushe! Mbushe me gaz se t'u fik motori! A nuk ta ndien veshi? Marshi i dytë! Mbaj mesin e rrugës!

Makina dilte në tatëpjetë dhe prapë në kabinë gjëmonë:

— Marshi i tretë! Mbaje të lirë timonin. Mos u nguros ashtu! Rregullo duart se t'u këmbyen! Hap rrugë dhe freno!

Dhe Kujtimi 15 — vjeçar priste timonin djathtas dhe hapte udhë aty ku rruga ishte më e gjerë. Po afrohej një traktor. Gjëmimi i tij mbyste zhurmën e makinës. Traktoristi nxirrte kokën dhe thërriste:

— Ta mori zanatin, Sotir! T'u bë djali burrë!

— Akoma jo, — ia kthente Sotiri dhe këmbente një cigare me traktoristin. — Ehu, sa ka zanati!

Pastaj Kujtimi i lëshonte vendin tet. Asfalti kishte mbetur pas dhe rruga tani ishte gjithë gropë dhe e ngushtë.»

* * *

Ena me ujin e nxehtë po i digjte gishtat. Avulli që dilte nga gryka e gjymit i fashitej pas trupit. Kujtimi nxitonë drejt garazhit ku ndodhej makina. Hapi dyert, ndezi driten dhe lëshoi enën përpëra makinës. I erdhi frottull një copë herë, kontrolloi gomat, i goditi me këmbë ashtu siç bënte i ati, preku me dorë zinxhirët e lidhur fort në gomat e pasme dhe u mbështet pas karrocerisë.

«A do ta ngas dot mbi dëborë? Po sikur të rrëshqasë nga rruga? Ah, baba, baba, që nuk ma le njëherë timonin kur rruga ishte me akull! Ta kisha provuar të shkretëni njëherë në një rrugë me akull dhe dëborë!»

Hyri brenda në kabinë dhe futi çelësin në vend.

«Po ushtari i sëmurë? Si tha infermierja: ai duhet të jetë për dy orë në duart e doktorit! Jo, jo! Nuk do të vdesësh o ushtar! Unë do ta ngas makinën edhe mbi dëborë!»

U hodh poshtë; hapi kapakun dhe gjymin me ujë të nxehthë e derdhi në tubin e radiatorit. Duke gurgulluar uji nëpër tub, ndiente edhe gurgullimën e gjakut që i lë-vrinte në deje. Shtrëngoi vidën e radiatorit, mbylli kapakun dhe hyri në kabinë. Mori manivelën dhe doli përpura makinës.

Oh, sa vështirë është të rrotullosh manivelën e një zisi! Vetëm një shofer i mirë mund ta përdorë atë me lehtësi. Ka një sekret ajo lëvizje e atij hekuri dhe këtë sekret e dinte edhe Kujtimi. Duart iu skuqën dhe filluan t'i dje-gjin nga doreza e manivelës. Në çastin që po i mbaroheshin fuqitë, makina u ndez! Kujtimi menjëherë hyri në kabinë dhe shkeli gazin. Motori gjëmoi brenda në garazh.

Ai nuk e dinte se gjithë fshati ishte çuar në këmbë dhe shtëpia e tij ishte mbushur plot njerëz. Fshatarët kishin marrë vesh që jeta e një ushtari ishte në rrezik, kishin flakur rrobat e ngrohta të gjumit dhe kishin dalë nga shtëpitë.

Të gjithë mbajtën vesh... Gjëmimi i motorit u çeli fytyrat!

— Eshtë i biri! — thërriti dikush me zë të lartë.

— Po, Eshtë im bir! — tha nëna pranë të sëmurit.

Makina uturinte te sheshi i fshatit. Boria e forte gjëmonte përmes dëborës.

Kujtimi po priste. Ai pa se shumë njerëz nxitonin drejt tij dhe thërrisin:

— Eshtë i biri!

— Eshtë i biri!

ZJARRET E NGRICAVE

Ai dhjetor kishte filluar me ngrica të mëdha.

Ngricat kishin ardhur fare papritur dhe prania e tyre të dukej e çuditshme, mbasi atyre anëve, me ngricat e para, pritej edhe dëbora e parë. Megjithatë dëbora po vounte atij dimri, dhe në qiellin e kaltër nuk po dukej asnjë re. Ditën dielli ngrohte pakëmbël, por menjëherë me perëndimin e tij, fillonte ngrica e hidhur.

Edhe nata vinte shumë shpejt. Natën, me qiellin plot yje, të dukej sikur nga këto shkëndija të largëta derdheshin atyre anëve rrymat e ftohta të ajrit, që përplaseshin pa mëshirë mbi tokë.

— Po vazhdoi kështu, do të na prishen bimët, — thoshin bujqit. — Deri tani bima po i qëndron ngricës, por po mbajti dhe nja dy a tri ditë ky thëllim i tillë, i përzhitit fare.

Bujqve, që e kishin mendjen gjithë te të mbjellat e vjeshtës, u dukej sikur nata vinte shumë shpejt. Të gjithë mendonin se nata vinte aq shpejt, ngaqë ishte dita e shkurtër, kurse dikush mendonte se nata vinte shpejt, që të lëshonte ngricat dhe të bënte tokën kallkan.

Bujqve u prishej gjumi, dhe duke hapur sytë në errë-

sirë, vështronin nga dritarja sfondin ku dukej qielli i kaltër me yjet që ndrisnin si gjithnjë.

...Dhe shqetësimi i tyre përplasej në xhamin e veshur me një shtresë akulli dy-tri milimetra të trashë.

Po vazhdoi kështu do të na prishen bimët!

Ai dhjetor kishte filluar me ngrica të mëdha.

*

*

*

Agronom Agimi ecte në rrugën e ngrirë, veshur me pallton e trashë dhe jakën të ngritur lart; nxitonte në udhën e mbushur me gjurma të ngrira kafshësh, duke shkelur mbi cipëzat e akullit që kërciste. Në të dy anët e udhës shtriheshin arat e mbjella me grurë. U hodh mata-në ledhit dhe hyri në parcelën e mbjellë. Qëndroi një çast me duart në xhepa dhe vështroi gjatë qiellin.

Iu duk sikur e gjithë e ftohta e natës iu derdh mbi trup.

«Prapë ftohtë sonte! — tha me zë duke folur me vete. Më ftohtë se natën që shkoi!»

U përkul dhe vuri pëllëmbën mbi tokë. Gishtat filluan t'i mpihen dhe t'i djegin. Nxori nga xhepi elektrikun e dorës dhe ndriçoi vendin ku pak më parë kishte vënë pëllëmbën. Bima e njomë e grurit dukej sikur dridhej, sikur ankohej, sikur kërkonte ndihmë nga drita që kishte rënë mbi të.

«Edhe bima ka filluar të vishet me okitë, — mendoi agronomi i shqetësuar. — Duket si e ngrirë, si pa jetë, sikur kërkon ndihmë nga unë... Duhet bërë diçka...»

Ishte i vetëm në mes të fushës. Vështroi edhe një herë qiellin e xhamtë dhe ndjeu një dridhje të lehtë që i përshkoi përsëri trupin. Mbjelljet e vjeshtës përfunduan në

kushtet më të mira, fara mbiu, bima doli për bukuri, kurse tani, na! prite të keqen nga ky dimër me qellin xham.

Duke ecur rrugës për në fshat, ai ndjeu se veshët i kishin ngrirë dhe, kur i preku me gishta, i dhembën aq sa iu duk sikur do t'i binin. Ai nxitoi në rrugën që ndriste nga hëna dhe, kur doli në qafë të kodrës, përballë pa dritat e fshatit.

«Nuk kanë rënë të flenë — mendoi për kooperativistët.— Nuk kanë as ata gjumë. I bren meraku për grurin, për bukën e tyre».

Mendoi njëherë të mos shkonte drejt e në shtëpi, por të kthehej nga vatra e kulturës ku dukej që ndrisnin dritat.

«Aty do të jetë dhe Mimoza, — tha me vete, për përgjegjësen e vatrës së kulturës. — Mbase aty do të më larohet ndopak shqetësimi...», por shpejt ndërroi mëndje. Atë çast e ndjeu veten tepër të lodhur dhe të uritur. Gjithë ditën kishte ecur arave, kishte shkuar në çdo brigadë dhe kudo që pat vajtur, i njëjtë shqetësim në çdo fytyrë dhe në çdo shikim bujku.

«E more djalë, si t'ia bëjmë hallit që na ka zënë?— dukej sikur thoshin sytë e të gjithëve.

Dhe Agimi ishte ulur për një çast bashkë me koooperativistët, kishte dredhur dhe oigare nga kutia e tyre. Duke biseduar me ta, prapë i qe dukur vetja i dobët përt'i bërë ballë së keqes që kërcënonte natën fushat e mbjella.

— Unë ia qaj hallin atij grurit aty !, — pat thënë xha Minai, duke treguar me dorë arat e mbjella pas brengut të lumit. — Është farë e re ai grurë, sivjet po e provjmë për të parën herë në tokat tonë. Ku i dihet ?... A i qëndron dot vallë ngricës?

Bujqit e tjerë kishin pohuar me kokë dyshimin e Minait, të atij shoku që ishte bujk i zoti dhe me përvojë.

— Sikur ti tymosim? — kishte thënë Agimi.

— Është e kotë, mor djalë, — ia kishte pritur xha Kristaqi, që rrinte i menduar me një fije bar në buzë.

— E kotë është... — Ai këto fjalë i pati thënë duke mos i hequr sytë nga arat që kishte treguar Minai. — Ka bërë dhe një mot tjetër kështu, — pat shtuar ai. — E provuam të ndiznim zjarre dhe të bënim tym mbi arat, po asgjë nuk fituam. Vetëm sa dogjëm kot së koti zahirenë e kashtës dhe mbetëm në pikë të hallit atë dimër... Frynte erë, kodër vendi këtu, nuk rri i qetë tymi mbi arë... Se është tym de, dhe nuk e lidh dot me litarë!...

«Po, është tym, nuk e lidh dot me litarë që ta detyrosh të shtrihet mbi fushë...»

Duke sjellë këto nëpër mend Agimi arriti te stallat e kooperativës. Kaloi përmes fshatit. Ishte hera e parë që ai nuk po hynte në vatrën e kulturës duke kaluar asaj rrugë. Në sallë ishte qetësi. Nuk dëgjohej asnjë zë. Agimi u nder mbi dritare dhe vështroi brenda. Në një tavolinë po luanin shah, dikush po lexonte gazeten, kurse Mimoza po shfletonte numrin e ri të revistës «Ylli». Agimi pa dashje vuri buzën në gaz. Iu duk sikur Mimoza çoi kokën dhe e pa, por nuk ishte e vërtetë. Ajo po lexonte diçka dhe e përsëiste më mend duke çuar kokën lart. «Si zogu kur pi ujë! — mendoi Agimi duke vështruar gushën e bardhë të vajzës. — Mos më prit sonte Moza! — iu duk sikur i tha asaj. — Jam shumë i lodhur dhe më ka marrë uria. Ta dish sa kam ecur sot unë!...»

U largua nga dritarja dhe u nis në shtëpi. Qeni e ndjeu që larg dhe i dolli përpara duke tundur bishtin si t'i uronte mirëseardhjen. Agimi e pa se qeni nuk rrinte dot në një vend; ai ngrinte nga toka herë njëren këmbë dhe herë tjetrën.

«I ngrijnë putrat — mendoi. Ja, nuk i mbani dot të dyja këmbët e para në tokë!»

Hapi portën, ngjiti shkallët e shtëpisë, kur dëgjoi se në dhomë po bisedonin.

«Do të ketë ardhur përsëri xha Minai me Kolin, — mendoi, duke hequr çizmet. — Ata nuk i zë gjumi, dhe vijnë e bisedojnë me babanë deri vonë».

Hyri brenda.

— E ?!

— Më ftohtë se mbrëmë !

I ati, që po rrinte pranë zjarrit, çoi kokën dhe vështroi të birin në sy. Ai vetë ishte bujk dhe e dinte shqetësimin e të birit. Hodhi gazeten mbi dyshek dhe duke shtrirë duart përpara stufës së ndezur tha:

— A e sheh? Në jemi brenda, zjarri po kërcet dhe prapë kemi ftohtë. Po bima? Si duron vallë ajo ?!

Agimi nuk foli. U ul në cep të shtratit pranë s'ëmës dhe vështroi të atin se si fërkonte pëllëmbët përpara zjarrit.

— Keq do ta kemi punën sivjet, — tha Minai duke dredhur cigaren. — Do ta kemi keq me planin e grurit... Kemi dhënë fjalën...

Agimi u ul në tavolinë për të ngrënë darkë. Pak më parë kishte ndier ura të madhe, kurse tanë, porsa mbushi lugën me supë, e kuptoqi që nuk hante aq sa kishte menduar një çast në udhë e sipër. E éma i kishte gatuar një supë të shijshme me mish pule dhe i kishte ruajtur të birit thelën më të madhe. E dinte nëna që i biri do të vinte i lodhur dhe i uritur. Ajo i kishte thënë disa herë që të merrte me vete pak bukë kur nisej për punë, por Agimi nuk ishte mësuar ende me këtë gjë. Ai nuk kishte më shumë se pesë muaj që kishte filluar punën e agronomit, dhe akoma i dukej sikur në mëngjes nisej për në auditor dhe jo

për në arë. Vetëm kur dilte nga shtëpia kujtohej për këtë dhe vinte buzën në gaz.

— Zjarrin ta ndeza në dhomë — i tha nëna. — Di unë? Oxhaku sikur ktheu njëherë tym... Mbase ndërron moti...

— Dëbora e shpëton grurin — tha babai.

Agimi mbaroi së ngrëni darkën. Tek po rrinte aty në karrige dhe po dëgjonte bisedat e burrave, biseda të përsëritura, por që ngjallnin mjaft interes profesional, ndjeu se po i vinte gjumi.

U çua dhe tha se i flihej. Babai e dinte se djali i tij lodhej shumë. Ishte i ri në zanat dhe fillimi gjithnjë është i vështirë për cilindo.

U ngjit në dhomën e tij. Vështroi për një çast i mënduar fashën e dritës që dilte nga vrima e porit të ndezur dhe binte në dysheme. Zjarri bubullinte dhe flakët që dri-dheshin e bënin fashën e dritës të luhatej. Nëna e kishte ndezur me kohë zjarrin dhe dhoma ishte ngrohur. U ul në karrigen pranë tavolinës dhe nuk i bëhej të zhvishej për të fjetur. Vështroi për një kohë të gjatë dritaren e mbushur plot me libra, dhe kujtimet shkollore gjetën dhe sonte shtegun e tyre për të biseduar me të.

«Eh, jetë studenteske, — mendoi, — iku koha jote! Auditorët e tu më kanë dërguar tanë këtu të provoj dijen dhe forcat e mia... Edhe auditori ka shqetësimet e tij: seminaret, kolokuiumet, provimet, por prodhimi paska provime më të vështira, ka teza me pyetje që as të kanë shkuar ndër mend se një ditë do t'i përgjigjesh...»

Por mendimin ia preu dera që u hap. Ishte babai. Ai u ul në karrige pa folur dhe filloi të dredhë një cigare. Babai ia zgjati kutinë edhe të birit që ta dridhte një herë. Sa ishte student djali nuk e kishte pirë duhanin në sy të të atit.

— Ikën xha Minai me Kolin? — pyeti i biri.

Babai nuk u përgjigj, po tundi kokën.

Agimi e ndjeu veten të vogël përpara babait. Prania e tij e ndrydhte pérbrënda dhe pérherë të parë donte që të ishte vetëm, të mos i fliste njeri.

— Ngricë e mallëkuar ! — tha babai duke nxjerrë përpara tymin e duhanit. — S'ke ç'i bën ! — ofshau duke c mënjanuar kokën majtas ? — Fabrikë pa çati ! E lëron tokën, e zgjedh farën pér bukuri dhe të vjen nga s'e pret.

Djali përsëri nuk u përgjigj. Nderi dorën mbi tavolinë dhe mori një letër të bardhë. As ai nuk dinte se çfarë po bënte ashtu. Filloi të palosë letrën dhe e kuptoi se po i dilte një vapor nga ata që luajnë fëmijët. E shpështolli letrën dhe filloi të bëjë një lodër tjetër që i kujtoi fëmijërinë. E vështroi i çuditur : kishte bërë një fluger prej letre !

— Ç'e ke atë ? — pyeti babai.

— Fluger, — tha djali.

Babai u bë gati të vërë buzën në gaz, po nuk mundi. Po të mos e shqetësonte diçka, ai do kishte qeshur.

— Fluger... — belbëzoi babai. — Ti i ke pasur shumë qejf flugerët kur ishe i vogël. Unë të kam bërë njëherë një prej teneqeje të hollë. E mban mend ?

— Po, — tha djali, — më kujtohet. Edhe atje në shkollë kishim një fluger në parkun e meteorologjisë. E kishim mbërthyer në një shtyllë të lartë.

— Përse duhej ? — pyeti babai. Ai nuk mërzitej kurrrë kur bisedonte me të birin. E dinte që djali nuk thoshte asnëherë fjalë pa vend.

— Flugeri tregon drejtimin e erës, — shpjegoi i biri.

— Unë gjithnjë e vështroja flugerin e institutit. Përherë e shikoja, kur kaloja afër tij. Ishte në të hyrë të institutit.

— E di, — tha babai.

— Të kam treguar ?

— Po.

Djalit iu kujtua se i kishte folur njëherë të atit për atë flugerin e madh në parkun e meteorologjisë. I kishte thënë se sa herë që e shihte atë, i kujtohej ai flugeri që i kishte bërë ai kur ishte i vogël. Babai kishte qeshur.

Babai u çua dhe doli nga dhoma. Agimi shkoi tek dritarja dhe vështrimi i tij u tret në qiell. Ashtu siç qe mbështetur te parvazi i drirates, ndjeu erën e ftohtë që frynte nëpër të çarat dhe i dukej sikur dikush e pickonte në trup. E gjithë qenia e tij ndiqte me shqetësim të ftohtët e natës. Pëstaj shkoi te tavolina, hapi sirtarin dhe nxori që andej termometrin e tokës. E futi në xhep të palltos dhe doli jashtë. Pak më larg shtëpisë ishte një arë e mbjellë më grurë. Mbërriti aty gati me vrap, shtriu në pozicionin e duhur termometrin mbi tokë, midis bimëve të njoma.

Kishte kaluar gati një çerek ore (këtë kohë ai e mati me dy cigaret që piu radhazi), u përkul, ndezi elektrikun dhe lexoit:

— Minus 7°!

«Kjo është e tmerrshme, — mendoi. — E tmerrshme për varietetin e ri të grurit! Po sikur të ulet temperatura edhe më?»

Vendosi termometrin përsëri mbi tokë dhe u kthye në dhomë.

«Nuk po fryn erë...» tha gati me zë dhe çoi kokën lart sikur të desh të shihte atë flugerin e parkut të institutit. Me duart që i dridheshin nga padurimi mori një letër të bardhë nga tavolina dhe filloi të bëjë flugerin e fëmijënisë. I mbërtheu një gozhdë shkopit, dhe me fluger në dorë doli përsëri jashtë, duke vrapuar drejt arës ku kishte lënë termometrin. Flugeri vërtitej e vërtitej! Agimit i dukej sikur po luante si atëherë në fëmijëri kur rendte për të rrötulluar flugerin që i kishte bërë babai.

Hyri në arë. Flugeri vazhdonte të rrötullohej gjersa

më në fund pushoi. Agimi kishte qëndruar në mes të arës. Kthehej me kujdes në të gjitha pikat e horizontit dhe nuk ia ndante sytë për asnjë çast flugerit prej letre.

«Nuk fryn erë!... Nuk fryka pikë ere! Xha Kristaqi tha se atë mot që kishte bërë kështu koha, kishte qenë thëllim i madh dhe frynte erë!... Nuk fryn erë! Nuk fryn jo-o-o!»

Shkoi te termometri dhe lexoi:

— Minus 9°!

«Nuk duhet ndenjur duarkryq! Gruri mund të durojë deri minus 12°, më tej ai thahet, përzhitet fare!...»

Agimi e dinte se pas mesnate temperatura do të ulej akoma më shumë. Ai e dinte këtë. E kishte ditur që më parë, pa shkuar në shkollë, i kishte treguar babai. Babai gjithnjë i kishte treguar mjaft gjëra interesante. Kishte baba të mirë ai dhe të zotin në punë bujqësie!.

Ashtu me fluger në dorë, ai nxitoi drejt sheshit të fshatit. Gjëmimi i kambanës së alarmit tundi gjithë vendin. Fshati u zgjua. Të gjithë bujquit që flinin me mera-kun në zemër ishin të parët që u mblohdhën përpara zyra-ve të kooperativës. Pyesnin njëri-tjetrin përsë të ishte ky alarm pasmesnate, në mes të këtij të ftohti që të thante.

Agimi, djali i fshatit, agronomi i tyre, kishte tundur me furi kambanën e alarmit duke thyer qetësinë e natës me ngricë.

«— A do të më dëgjojnë vallë? A do ta përkrahin mendimin tim? Apo do shkrihen gazit kur të filloj?... Jo, kooperativistët me përvojë do të më dëgjojnë! Ata gjith-monë më kanë dëgjuar, edhe unë kam dëgjuar fjalën e tyre!»

Më në fund u vendos qetësia. Tek-tuk dikush përplaste këmbët pas tokës së ngrirë.

— Shokë! Më dëgjoni ç'do t'u them: të shpëtojmë grurin nga ngricat!

Njerézit lëvizën. Dikush fishkelleu habitshém. Andej nga fundi njéri qeshi me ironi.

— Brigadierét tē marrin forcat e brigadave, bujgit tē mbrehin qerret. Tē merret kashtë nga müllarét e vjetér dhe nē çdo cep are tē mbjellë bëni nga një grumbull. Sidomos nē parcelat ku kemi mbjellë farën e re. Fillojmë që tani. Koha nuk pret.

— Ohoho, do ndezim zjarr!

— Do ngrohim arat me flakë kashte!

— Posi ore, mendje cilimiu!

— Agimi ka tē drejtë!

— Drejt e ka: nē fshatin ku kam martuar unē çupén, aty poshtë, nē fushç, me tym i luftojnë gjithnjë ngricat!

— Ne nuk jemi nē fushë, këtu te ne nuk pi ujë tymi!

— Nuk fryn fare erë, ja ndieni gjë ju?

— Vërtet, nuk fryn erë!

— Në sulm i gjithë fshati!

— Lajmëroni me telefon sektorét e tjerë tē kooperativës.

— Shpejt shokë, se sa vjen bën akoma më ftohtë!

Nuk kaloi shumë kohë dhe nē rrugët e fshatit kërcitën rrotat e qerreve. Nëpër kodrat dhe kudo që tē hidhje sytë u dukën fenerët e parë. Fenerët lëviznin drejt arave. Të dukej sikur atmosferën e ngrohu lëvizja e njerëzve dhe tē thirfurat e tyre nga njëra arë tek tjetra:

— Ehej! Të bëhet sa më shumë tym! Kashtën e thatë lageni, spërkateni me ujë!

— E ku ta gjesh ata ujë, mor byrazer! Nuk e sheh se është bërë kallkan toka?

— Thyejeni akullin e lumit!

U ndezën zjarret e para. Tymi shtëllunga-shtëllunga hapej ngadalë dhe pushtonte gjithë parcelën e mbjellë. Të dukej sikur ishte formuar një qiell i dytë pa yje. Vetëm

tek-tuk dukeshin shkëndijat e zjarrit si yje të vegjël të pa-fuqishëm për të ndritur.

— Në krahasim me këtë qìell artificial prej tymi, një-rëzit që ecnin nën të dukeshin më të mëdhenj, gjigantë:

— Ehe-hej! — po thërriste dikush nga maja e një kodre: — Tymin po ma merr era dhe nuk kam ç'të bëj!

— Mbaje, mbaje, mos e lër të ikë gjersa të vjmë ne!
— ia ktheu një shakaxhi që poshtë.

— E pse të mos tallesh ti? — thoshte tjetri. — Ne po na zien koka, ti ke kohë të bësh dhe shaka!

— Hidhi pallton sipër erës! — vazhdonte hokatari.

— Ajo ara ku je ti mbulohet edhe me një bataniqe!

— Pse, do tallesh a!

— Shkru!... Shokë, filloj të shkrijë okita nga bimët!

Kryetari i kooperativës dhe agronom Agimi, të lodhur pa masë, erdhën dhe u ulën pranë një zjarri në mes të bujqve.

— Tani nuk ua kam më frikën ngricave!, — tha kryetari, pa u ulur mirë.

— As ne nuk ua kemi më frikën ngricave! — thanë kooperativistët e tjerë.

Kryetari i hodhi dorën në sup Agimit dhe e përqafoi. Agimi ende po mbante në dorë atë flugerin prej letre. Nuk i bëhej ta hidhte atë fluger...

Qielli vazhdoi të jetë i kthjellët edhe disa net të tjera. Gjatë atyre netëve, në lugine e në arat përqark sa të shihnin sytë, vazhduan të ndrisnin edhe zjarret e ngricave.

DASMA E ÇIFTIT SYKALTËR

Nga mezi i gushtit, kur unë ende bëja pushimet e vërsës, u nisëm të dy me tim atë për në një fshat të largët mëlor, të ftuar në një dasmë. Më kujtohet se atëherë isha akoma gjimnaziste, kisha mbaruar klasën e tretë dhe ndihesha shumë e gjëzuar që po shkoja të merrja pjesë dhë unë në një dasmë fshati.

Brenda në autobus ishte vapë, dielli më binte në sy, goja më qe tharë fare. Gjatë gjithë rrugës qëndroja afër dritares. Para syve të mi parakalonin fushat e gjera me grurë dhe herë — herë grumbuj shtëpish, fabrika, dhe kallimtarë shpesh hipur mbi bicikleta.

Autobusi filloi t'i ngjitej një mali të lartë. Menjëherë flladi i freskët më përshkoi gjithë trupin. Rruga ku po kalonim ishte me kthesa. Unë fillova të sodisja edhe më me endje bukurinë mahnitëse që shtrihet para nesh. Tani përpara nesh shtriheshin vetëm male. Edhe më të djathëtë kishim vetëm male. Kurse në krahun tjetër shtrihet fusha e gjerë që sa vinte dhe po mbetej pas. Gjatë rrugës malore të shihte syri dhe ndonjë arë të vogël të taracuar, ku misrat tundin xhufkat e thata. Pak më lart, disa qerre të ngarkuara dinga me bar na hapën udhë.

Autobusi qëndroi. Im atë më shpoi me bërryl, dhe më tha se duhej të zbrisnim. Në stacionin ku zbritëm nuk kishte njeri. Buzë rrugës ishte një gorrice e madhe, më tej një lapidar i lartë dhe pas lapidarit disa shtëpi të një fshati, që mezi dukeshin nga pemët. Pas gardhit rrethues të një shtëpie, ishin lidhur dy kuaj të kuq dhe një mëz pullali. Të tre kuajt po hanin jonxhë të thatë. Pak më tej, mbështetur pas gardhit, po rrinte një djalosh që nuk po na i ndante sytë. Na vështronë me vëmendje dhe po fishkëllente një melodi të ngatërruar. Më bëri përshtypje veshja e tij. Në kokë mbante një kapelë të bardhë prej kashte; fytyra e tij, e hequr e ezmere mbaronte me një mjekër të rrumbullakët dhe me një gropëz të thelluar në mes. Ishte një djalë muskuloz, me gjoks të gjerë, që i dukej përmes këmi-shës së bardhë të shkopsitur.

Ai, kur na njobhu, hoqi kapelen dhe erdhi drejt nesh me hap të shpejtë e na tha:

— Ejani. Kuajt janë gati. Në dasmë shkonë, në mos gabohem.

— Sigurisht që për atje jemi nisur, — tha babai duke vënë buzën në gaz dhe u nis menjëherë pas djaloshit duke më thënë: — Eja Leti. Kanë dalë të na presin!

— Vajza të hipë në këtë kalë, — tha djaloshi duke u kthyer nga unë. — Është i sigurt dhe i shpejtë në ecje.

— Jo... Kam qejf të eci, — thashë me gjysmë zëri. — Pastaj unë nuk kam hipur kurrë në kalë.

— Hip, hip! Nuk është ndonjë gjë e madhe, — ma preu babai. — Është rrugë e gjatë. E di unë...

Djaloshi po më vështronë i çuditur. Kishte ngritur njérën vetull lart sikur po mundohej të zbulonte në isha vajzë frikacake, apo më vinte zor të eoja kaluar. Kishte sy të kaltër. Baluket e zeza i vareshin nën kapele mbi ballin e drejtë. Hundën e kishte paksa të krusur dhe kur vinte buzën në gaz i dukeshin dhëmbët e vegjël si rruaza

të bardha. Fytyra e tij e pastër dhe e bukur, shikimi i çiltër dhe buzëqeshja çapkëne, më bënë të mendoja se nuk do të ishte mirë po t'ia prishja qejfin.

Pra vendosa të hipja dhe ai më lëshoi kapistrën në duar. Ishte hera e parë në jetën time që hipja në kalë. Im atë, që kishte hipur në kalin tjetër, po queshte:

— Tamam kalorëse dukesh Leti! Shiko, mbahu mire!

— Do ta kem unë kujdeš kalin e saj, — tha djaloshi, dhe me një kërcim të shpejtë prej atleti u hodh në shpinë të kalushit që nuk kishte as samar dhe as kapistër.

Më kujtohet se në atë vapë kapitëse, meqë udha ishte pa hije, ai hoqi kapelen nga koka dhe ma dha mua. Hërrëherë mëzi që kishte hipur ai dilte përpara dhe nxitonë revan në udhën e ngushtë malore, të freskët dhe pa pluhur. Pastaj djaloshi ndezi një cigare që ia dha im atë dhe filloi ta pijë me ëndje, duke vështruar diku përpara. Më dukej sikur tani po dëgjonte, hapin monoton të kuajve, apo sikur maste me vështrim dhe sa rrugë na kishte mbetur për të hyrë në hijen e aheve.

— Pra, dasmën e keni nesër mbrëma? — pyeti papritur babai.

Djaloshi tundi kokën.

— Ti je djali i Simos?

Djaloshi përsëri tundi kokën.

— Unë kam kohë që nuk jam takuar me babanë tënd, — shtoi im atë, — dhe kam harruar se sa djem ka ai...

— Dy djem, — u përgjigj djaloshi.

— Të jeni me jetë, — uroi im atë pa e zgjatur bisëdën më tej.

Pas një ore mbërritëm në fshat. Rrugët ishin të shtruar me kalldrëm, çatitë e shtëpive të mbuluara me plloça dhe në çdo qoshe të rrugës derdhej nga një çezmë. Më kuj-

tohet se hymë në një shtëpi të lartë me dritare të ngushata. Parvazet e dritareve i kishin lyer me gëlqerë nga jashtë. Një burrë doli na priti në krye të shkallëve. Ai qe rrreh të pesëdhjetave, trupmadh, pa kapelë. Na përshëndeti përzemërsisht dhe na udhëhoqi brenda. Dhoma ishte e shtruar thjesht: një qilim i trashë plot lule mbulonte dyshemenë; mbi tavolinë një vazo me lule mali, agulice dhe manushaqe. Kishte dhe disa lule të tjera që unë për herë të parë i shihja. Anës murit një kanape e punuar trashë dhe nga që qe lëmuar shumë, kishte marrë ngjyrë çaniku¹). Ndërkokë u dha tek dera djaloshi që na kishte shoqëruar.

— Ligor, thuaju grave të vijnë të takohen me mysafirët.

Ligori, kështu quhej djaloshi, vuri buzën në gaz, hoqi kapelen prej kashte, sheshoi me gishta flokët e zez kacurrelë dhe tha duke u ulur në kanapenë ku rrija unë:

— Tani vijnë baba.

U dëgjuan hapa të lehtë që po ngjitnin shkallët e gurta. Në korridor dikush pëshpëriti: «Prit nuse, rregullo shaminë!» «Më mirë po e heq fare mama». Në prag të derës u dha një grua shtathedhur, llérëpërveshur, me tipare të ngjashme me ato të djalit që rrinte afër meje. Pas saj hyri një vajzë leshverdhë, sykaltër, mjaft têrheqëse, me një përparëse të bardhë lidhur në mes mbi fustanin me lule.

— Ja dhe nusja... — dëgjova kur po përshëndetesha me të zonjën e shtëpisë. Nusja më dha dorën, më vështroi drejt në sy me atë vështrimin e saj të kaltër, dhe unë i hodha dorën në qafë duke e ulur pranë meje si një shoqe të vjetër. Ishte pak më e gjatë nga unë, flokët të lidhur nga mbrapa me fjongo, kokën e mbante ulur, pak si e tur-

1) Çajanik — lëvozhgë arre.

përuar; kurse në fytyrë i endej një buzëqeshje e ngrohtë.

— Po dhëndri? — pyeti papritur im atë.

— Dhëndri?! Po, ja ku e ke përpara! — tha i zoti i shtëpisë dhe tregoi me dorën e tij të madhe të birin që po rrotullonte në duar kapelën prej kashte.

— Oj, oj, dhe unë nuk e dija, as që më shkoi ndër mend! Kujtova sé do të ishte ai tjetri më i madhi: Po pse ore djalë nuk më the rrugës, se ti?... Të dy sykaltër! Shiko, shiko ç'kombinim ngjyrash! Të trashëgoheni dhe jetën ta keni të pastër si sytë tuaj!

Kjo ndodhi fare papritur. Ne as që na kishte shkuar ndër mend se djaloshi që na kishte shoqëruar gjatë rrugës ishte dhëndri. Dhe kjo kishte ndodhur se im atë nuk e pyeti më tej djaloshin rrugës duke ardhur dhe as djaloshi nuk na tha ndonjë fjalë.

Pak më vonë u shtrua sofa dhe ne hëngrem drekë. Pas buke pimë nga një gotë dhallë. Dhalli i ftohtë prej qu-mështi deleje më freskoi e gjallëroi.

Babai ishte hequr mënjanë me të zotin e shtëpisë dhe po kujtonin ngjarje nga lufta. Ata të dy kishin shumë pér të kujtar, prandaj ishim ftuar edhe një ditë përpara dasmës. Ata kishin qenë të dy partizanë dhe më të njëjtën brigadë. Historitë e tyre nuk kishin të sosur. Të gjitha ato ngjarje i dija dhe unë, m'i kishte treguar im atë kushedi sa herë.

Duke dëgjuar bisedën e dy burrave, fillova të sodisja që nga dritarja peizazhin e bukur malor që rrethonte fshatin nga të gjitha anët. Plaku i shtëpisë ndërpreu bisedën dhe tha duke u kthyer nga unë:

— Mos është lodhur gjë vajza nga rruga dhe i flihet?

Unë thashë se nuk ishë lodhur fare dhe nuk më fli-hej. Nusja më vështroi në sy.

— Dalim jashtë? — më pyeti ajo pas një grime me zë të ulët.

Dolëm. Një erë e mirë mishi të pjekur, përzier me atë të patateve të fërguara, vinte që nga kuzhina verore. Nëpër barin e oborrit po vraponin disa lepuj të vegjël, të bardhë, duke u hedhur njëri pas tjetrit me shpejtësi. Një qen i madh, me majat e veshëve të prera, bishtin po ash-tu, qe shtrirë nën hijen e një peme dhe tundte bishtin e cunguar duke e fërkuar pas barkut me qime të gjata, të bardha dhe të ndritshme.

— Mua më quajnë Manushaqe, — tha nusja papri-tur, duke më zënë për dore.

— Mua më quajnë Leti.

— Vete në shkollë ti?

— Po. Sivjet shkoj në maturë.

— Pra unë qenqam një vit më e madhe nga ti, — shtoi Manushaqja dhe buzëqeshi. — Unë kam një vit që mbarova shkollën e mesme për gjeometre. Ti çfarë do të bëhesh?

— Mua më pëlqejnë shumë zanate, — i thashë.

Kishim mbërritur në fund të oborrit. Aty ishte një çezmë me një postaf të madh prej druri. Postafi ishte i mbushur me presh dhe ujët derdhej nga sylinjari mbi ta. Manushaqja përveshi mëngët e trikos dhe filloi të lajë preshtë.

— Ti Leti mos u mërzit, se nusja, — tha ajo për vëten e saj, — ka akoma punë... Ne filluam të qeshnim të dyja.

— I ka dasma këto, — i thashë, — po më gjej dhe mua një përparëse.

Nusja buzëqeshi, fshiu dorën e lagur, futi një tufë flo-kësh nën shaminë që e lidhi në kokë dhe hyri menjëherë në kuzhinë për të marrë përparësen për mua. Filluam të dyja të lanim preshtë në çezmën e oborrit. Ujët ishte i ftoh-të dhe duart na ishin skuqur deri në bërryl. Manushaqja

dinte të lante më shpejt se unë. Mua më vinte zor dhe mundohesha që të mos mbetesha pas.

Për herë të parë shkoja në një fshat malor dhe për herë të parë atë ditë ndjeva freskinë e malit, qetësinë e tij, gurgullimën e ujit të kroit që kalonte jo shumë larg shtëpisë, aromën e luleve dhe erën e barit që e mban mali deri në prag të vjeshtës.

Një këngë buçiti diku në pyll. Ishte një këngë që këndohej nga zëra të hollë vajzash. Ajo rendte grykave të malit plot harmoni, e pasuar nga një kitarë që binte lehatas...

Një flutur sikur të isha,
Pranë teje do qëndroja;
Edhe ti të mos deshe,
Unë s'ndahesha prej teje.
· · · · ·

Kënga nuk kishte të mbaruar dhe kur Manushaqja më pa se i kisha vënë veshin, më tha:

— Këndojnë vajzat e fshatit, Leti! Vetëm të dëgjosh sa këngë dimë ne këtej!... Ato sot po korrrnin grurë dhe siç duket po shlodhen në hije. Gjithnjë, kur shlodhen, fillojnë të këndojnë. Mblidhen vajza e djem dhe këndojnë pa u lodhur gjatë gjithë pushimit të punës.

E vështrova Manushaqen në sy. Ajo i kishte thënë këto fjalë aq me ëndje, sikur atë çast të ishte kthyer nga ara ku po këndonin vajzat e fshatit. E kuptova që nusja priste me padurim sa të bëhej dasma dhe të kthehej tek ato vajza që po këndonin pa pushim.

— Të pëlqejnë luleshtrydhet? — më pyeti papritur Manushaqja.

— Po, — i thashë.

— Mali ynë i ka të mrekullueshme. Do të të çoj t'i

provosh? Më tregoi Ligori një vend këtu afër. Ka sa të duash. Luleshtrydhe mali nuk gjen kudo... apo jo Leti?

— Ja, sa të mbarojmë së lari perimet, — tha ajo, — pastaj do të shkojmë aty ku të thashë. Për sot nuk ka punë të tjera për të bërë. Vjehrra ime është grua e zonja dhe punëtore e madhe.

Pas pak hoqëm përparëset, rregulluam flokët dhe dolëm prapa kopshtit, aty ku shtrihej një pllajë e pjetrët plot me bar dhe me tumba fieri. Era e këndshme e luleshtrydheve, përzier me atë të fierit të njomë, shkrihej në një aromë dehëse që të bënte të mendoje se këta banorë të maleve i kanë gjithë të mirat në këtë vend kaq të ashpër në dimër, por aq të bukur dhe të gëzuar në stinët e tjera.

Manushaqja po mbledhë luleshtrydhe, mbushi grushtin dhe po më thoshte diçka me zë të ulët, — apo këshfu m'u duk mua, që isha kredhur e tëra në ëndërrime, — gjithë duke qeshur, më mbushi dorën me luleshtrydhe dhe unë i provova ato kokërrza të kuqe dhe të shijshme që të shkrinin në gojë.

— Je e lumtur që do martohesh? — e pyeta kur u ulëm nën hijen e një vishnjeje.

Ajo mbylli sytë përgjysmë duke e tretur vështrimin pas qerpiqëve të dendur dhe të gjatë. U kthyte nga unë dhe më tha:

— Jam shumë e lumtur Leti, po do të isha akoma më e lumtur sikur kjo dasmë të bëhej të paktën pas dy ose tre vjetësh...

— Përse?....

Fytyra e saj e bukur u trishtua pakëz.

— Nuk jam në moshë për martesë — tha ajo. —

Unë porsa mbusha të tetëmbëdhjetat... Është një histori jo fort e këndshme që e shpejtuam dasmën tonë...

— Leti, përse më vështron kështu? Ku të shkon

mendja?... Jemi njohur bashkë në Korçë, kur të dy ishim në shkollë. Ai vazhdonte një kurs bletërritës. Ne e duam shumë njëri-tjetrin.

Ia ngula sytë në sytë e saj dhe po e vështroja paksa si e habitur.

— Unë nuk jam nga ky fshat, — shtoi ajo pas pak, — me një hije trishtimi në fytyrë. — Jam nga një fshat poshtë në fushë... Familjet tona kanë pasur fe të ndryshme.. Dhe ti duhet ta dish se sa e vështirë është për ne. Kjo ishte pengesa kryesore në dashurinë tonë. Prindërit e mi, kur morën vesh për dashurinë tonë, bënë çmos që të na ndanin. Bile, arritën deri aty, sa deshën të më fejonin me zor me një tjetër... Më kupton Leti?

— Po pastaj? Ty të rrëmbeu Ligori? — e pyeta disi e lehtësuar.

— Unë nuk prita të vinte dhe të më merrete ai, — vazhdoi ajo. — Ai më kishte thënë se po të më detyronin prindërit të plotësoja dëshirën e tyre, unë duhej të vija këtu. Dhe erdha vetë. Ligori kishte biseduar me tim vëlla. Sa i mirë është im vëlla!... Prindërit e Ligorit më duan shumë. Unë i dua dhe i respektoj se janë njerëz të thjeshtë. Ligori është shumë i dashur, i thjeshtë dhe i pa-shëm... Po të flas ty, se je vajzë dhe më kupton mirë, një lloj sikur të kisha folur me një motrën time.

Manushaqja heshti. Unë u drodha. Gishtat më ishin mbledhur papritur grusht. Lëngu i kuq i luleshtrydheve po pikonte pikë-pikë mbi bar. Vështrova diku matanë kroit. Që aty fillonte një plajë e madhe mali, e veshur me pyll dhe më majë dukej një ndërtesë e bardhë.

— Shtëpi është ajo atje lart? — e pyeta.

— Jo, është posta kufitare...

— Qenka shumë afër kufiri....

— Pak më poshtë ka rënë xhaxhai i Ligorit...

— E di... Ai na tregoi rrugës kur po vinim për këtu.

Unë e pyeta edhe për diversantët. Manushaqja nuk dinte shumë gjëra për të më thënë, por, siç kishte dëgjuar, ndodhët shpesh që fshati çohej në këmbë i alarmuar, sa herë që dikush guxonë të shkelte vijën e kufirit.

Që sipër kroit vinte tringëllima e këmborëve të një kopeje me dhen.

— E-hej! Ligor! — thirri një burrë që sipër kodrës së vogël mbi pllajë. Ai duhej të ishte patjetër bariu i dheneve. Që mbështetur mbi një shkop dhe po vështronë nga shtëpia ku do të bëhej dasma. — Më prit nesër mbrëma se do të vij në dasmë! Do të ta pi kilen e rakisë, dëgjove? Kilen ore, kilen, në mos më shumë!

— Të vish xhaxha, të vish, ti ke vendin tënd në dasmën time! — iu përgjigj Ligori që nga dritarja e shtëpisë.

Ne po ktheheshim në shtëpi. Ecnim që të dyja të heshtura. Për mua atë çast mbasë do të ishte e kotë të thosha ndonjë fjalë Manushaqja patjetër që m'i kishte trenguar të gjitha. Ajo tani ecte përpara meje dhe mendonte gjithçka: për dasmën, për Ligorin, për urimet, për të vëllanë që e priste të vinte fshehurazi në dasmë, fshehurazi prindërve, atje në fshatin e fushës. Kurse unë mendoja: për të, për dasmën, për sazet, për köngët e rinisë së këtij fshati, përsëri për dasmën dhe për ata të dy.

Gjumi më doli kur në fshat kishte rënë mbrëmja. Ne ishim lodjur atë ditë duke bërë punë. E diela ka lodhje më shumë, se duhej të përgatiteshin tavolinat, mezetë, duhej pastruar shtëpia edhe njëherë që nga oborri deri te dhoma e vogël në katin sipër, ku kisha rënë për të fjetur

unë bashkë me Manushaqen. Nga zërat, urimet, të qeshurat me zë të lartë, nga zhurma dhe hingëllimat e kuajve të të ftuarve, më bëhej se në këtë dasmë kishte ardhur i gjithë Devollit.

Shtëpia tundej e tëra dhe të dukej sikur njëtej lart, drejt qiellit.

Fëshfériu një fustam. Ktheva kokën. Manushaqja po vishte fustanin e nusërisë. Dy vajza të tjera nga fshati po e ndihmonin për t'u rregulluar. Dëgjova që njëra i pëshpëriti në vesh:

— Po fjongon?

— Do ta vë... Ma jep!

— Më mirë lëri flokët të bien mbi supe, — e këshilloi tjetra. — Dukesh më e bukur... Përse nuk i drodhe flokët? Të paktën t'i kishe lidhur sot me bikutina... Ne e kemi zakon që vashat i dredhin flokët kur veshin fustanin e bardhë.

— Unë u mësova të thyej zakone! — tha nusja me shaka dhe lidhi fjongon e kuqe mbi flokët e verdhë.

U hap dera e dhomës. Një fëmijë me kokë të qethur fare tha shpejt e shpejt e me një frymë:

— Nuse! Ata po thërrasin poshtë, se duan të të shohin.

— Ja erdha...

Ato dolën nga dhoma, duke mbyllur derën me ngadalë. Unë u çova me të shpejtë, lava fytyrën me ujin e një kane që ishte mbi parvazin e dritäres, u kreha me kujdes, u vesha dhe dola. Në korridor hasa dy a tri gra që nxitonin me pjata në duar.

Kur dola në krye të shkallëve, orkestra ia mori një valleje të shtruar popullore. Shumë sy çapkënësh u drejtuan nga unë. «Mbase jam dhe unë e bukur» mendova dhe ashtu siç isha, më përfshiu gjëzimi i dasmës e hyra menjëherë në valle. Ndodhesha në mes të dy djemve vi-

ganë. Duart e mia të vogla i përfshinë duart e tyre të mëdha dhe e ndjeva se ato ishin me kallo, por të sigurta; prandaj m'u duk edhe vetja, ndoshta, më se e sigurt nën ritmin e këmbëve dhe të trupave të djemve që bënin të dridhej dyshemeja.

— Dhëndri! Ku është dhëndri! — thërriste ai që hiqte vallen. Ishte, me sa m'u duk mua nga zëri, ai bariu i dhenve që kishte thirrur me zë të lartë nga bregorja e malit.

Dhe dhëndri u dha në krye të shkallëve:

— Në fund, në fund e ka radhën dhëndri! — tha ai duke tundur kokën.

— Tani, more! — thërriste çobani. — Nusja hyn në valle në fund, dhëndri hyn në fillim!

Dashje pa dashje Ligori zbriti shkallët. Me një të kërcyer u gjend më krye të valltarëve. Gjëmoi daullja! Dola nga vallja. Krahët e burrave u pleksën fort si degë hardhish! Vargu u tendos! Ligori tundi njëherë kokën bashkë me shaminë, filloi vallen shtruar, serioz, fytyra i kishte marrë një pamje burrërore, hidhte këmbët me shkaftësi pas ritmit të daulles, pastaj vuri buzën në gaz, hapi fort sytë e kaltër dhe bëri një «hop» të fortë, duke u hedhur lart, sikur do të arrinte tavanin me kokë...

...Më kujtohet që, kur mbaroi vallja, valltarët ishin bëre quill në djersë.

Atë natë pashë për herë të parë në jetën time se si luhej ajo vallja e famshme devolleje.

Në dhomën tjetër dëgjohej kënga e grave. Këndonin një këngë me të zier, e cila, nuk di se si më bëri që t'i afrohesha grupit të tyre dhe t'ia merrja edhe unë asaj këngë dasme të gëzuar.

Kishte kaluar mesnata. Kisha dalë në oborr që të freskohesha pak. Rrezet e hënës kishin rënë në oborrin e gjerë rrëth e rrëth me pemë. Dëgjoheshin të përtypurat

e kuajve dhe tē mushkave aty afér meje, që hanin bar rrëzë gardhit, ku i kishin lidhur.

Dasma ndihej nē oborr. Ajo, mbase, atë natë ndihej nē tē gjithë fshatin, e ndiente tërë mali, e dëgjonin dhe kufitarët aty sipër, nē atë postën e bardhë që ndriste nga dritat. Ligori kishte ftuar nē dasmë edhe kufitarë. Ata dalloheshin nga tē tjerët nga rrobat e tyre tē gjelbra.

— Pau! Pau! krisën papritur disa armë. Kuajt u trembën, hingëllinë dhe u ngjeshën pas gardhit.

— Alarm!

Këngët pushuan menjëherë. Nga shtëpia filluan tē dilnin me vrap burrat që shtrëngonin pushkët nē duar. Dilnin me nxitim dhe, duke kaluar përpara meje, mbushnin armët, tërhiqnin shulet gjakftohtë dhe merrnin vra-pin.

Vura re se pas burrave, vrapuan edhe vajzat e gratë, duke rendur drejt qendrës së fshatit.

— Ligor! — thirri Manushaqja, duke zbritur shkallët. Ligori atë çast doli nga hauri, duke têrhequr për kapisstre kalin. Iu afrua nuses së tij dhe e puthi nē buzë.

— Mos u shqetëso! — i tha. — Ne do tē kthehem shpejt dhe dasma do tē vazhdojë përsëri.

Kali u lëshua nëpër oborr, doli nē rrugë dhe u nis nē pikë tē vrapi. Trokthi i tij sa vinte po shuhej dhe pas pak nuk u dëgjua më..

Në shtëpi kishin ngelur pak njerëz. Nuk tē zinte syri asnjë burrë. Të gjithë kishin shkuar për tē zënë shtigjet. Ne që ishim nē shtëpi, prisnim me nerva tē tendosura. Nuk na durohej derisa tē dëgjoheshin tē shtënat e armëve, që nuk vonuan tē buçasin nē gjithë malin.

Manushaqja doli nē dritare. Edhe ne që kishim mbeitur pa shkuar pas tē tjerëve, dolëm nē dritare dhe shikoni nga kufiri..

Në një kohë gjithë vendi ndriçoi nga një raketë që çau qiellin. Ishte sinjali se armiku ishte asgjësuar!

Pas ndonjë ore të gjithë u kthyen në shtëpi. Ishin lodhur shumë burrat dhe rinia! Ata i kishin zënë me kohë shtigjet.

Më në fund u dëgjua trokthi i një kali... Mezi po merrja frymë. «Po sikur... Po sikur!...» Por jo, Ligori ishte kthyer. Futi kalin në haur, vari armën aty ku i kishin lënë të gjithë. Sazet ia filluan përsëri, më me forcë, aq sa po mendoja se do të çuhej daullja.

Menjëherë kumboi kënga, një këngë e bukur partizane, një këngë që përmendte edhe kufirin dhe që u tregonte vendin të gjithë atyre që do ta preknin.

Këngët rridhnin njëra pas tjetërës:

Ma ka syrin si ulliri,
Mashalla, mashalla!...

Ajo është sykaltër, — korrigjova. — Sykaltër është dhe ai. Të dy janë sykaltër!»

Po të rintjtë ia filluan akoma më fort:

Kur vjen behari, çel qershia,
Vajzat e bukura...

Po të dyja këngët nuk ngatënröheshin. njëra me tjetrën. Tani kënga e grave po vazhdonte:

Ma ka vetullën si gajtan,
Mashalla, mashalla!..
Djalin që more e kemi më trimin
Të kaltër ka dhe vështrimin.

Vura buzën në gaz dhe vështrova çiftin sykaltër.
Edhe ata po buzëqeshnin.

Njerëz të çuditshëm këta malësorët! Sa shpejt i rregullojnë këngët dhe sa shpejt i këndoijnë, në çastin që duhet!

Dasma vazhdoi deri në mëngjes. Këngët dhe vallet nuk pushuan për asnjë çast. Dikush kishte thënë pak më parë që ne, rinia, të këndonim akoma më fort, me sa kishin në kokë, që të pëlcisin prej marazit ata matanë kufirit.

Kufiri ishte fare afër fshatit dhe patjetër këngët që kënduam ne gjithë natën i dëgjonin edhe ata...

Kjo na shtynte të mos pushonim për asnjë çast, duke mos lënë pa kënduar atë natë asnjë nga këngët tona.

F I T N E T J A

— Gjysho-o! Kush m'i ka marrë dylbitë nga dritarja?

— Ku ta di unë bre nip! Shiko nën krevat se mos i ka hedhur maçoku...

U hoqa zvarrë nën krevat dhe i gjeta. Maçoku ynë i verdhë po luante me to në qoshen e errët. Unë me ato dylbi kaloja kohën që nga dita kur rashë prej qershisë dhe theva këmbën, dhe askush, përveç maçokut, nuk m'i tra-zonte ato. Meqenëse isha një fëmijë ters, gjyshi thoshte përherë duke qeshur nën buzë: «Benit shejtan ia gjetëm më në fund ilaqin për të mos dalë jashtë».

Dola nga krevati me këmbën të lënduar, që më kruhej shumë nën allçimë e fortë. Disa ditë më parë nuk gjeja derman. Një ditë, fshehurazi prindërve, hapa një vrimë të vogël, hoqa shtizën nga çorapi i nënës dhe krova pulpën për shtatë palë qejfe në këndin tim. Pak më vonë mora dylbinë, hapa dritaren dhe vëzhgova fshatin. S'kishte mbetur pemë, rrugë, kodër, fushë, pa hyrë nëpër xhamin e dylbisë së vjetër! Megjithëse nuk dilja dot jashtë, prapë-serapë, gjithë peizazhin dhe ata që lëviznin në të, i kisha çdo çast pranë.

Drejtova dylbinë nga sheshi. Një mëz i bardhë hidhej sa andej-këndej, me këmbët e tij të gjata. Ai i binte rrrotull sheshit të stallave me një vrap të rrufeshëm. Ish-te ai mëz që rendte e rendte mëngjes e mbrëmje, fuste kokën nën barkun e pelës kërre, tundte bishtin me kënaqësi, puliste veshët e vegjël si fletë shelgu, dhe përsëri fillonte vrapin e çmendur nëpër shesh dhe në lëmenjtë ku shihej gruri. Burrat ngrinin lart sfurqet e gjata prej dru-ri dhe thërrisin plot ngazëllim:

— Y-ha-ha! Po-po ç'kalë do të bëhet ky! Këtë ta kesh ta futësh në врае!

Mëngjes. Dielli është ngnitur lart. Gjyshin e dëgjova që tha se sot, në fushën e mbjellë me grurë aty sipër mbi vreshtë, do të ngjitej kombajna.

Tek porta e teto Fotinës janë mbledhur plakat e mëhallës dhe kuvendojnë. Të tjerat dëgjojnë me duart futur nën mësallë, ndërsa teto Fotina po e tregon me duar e me këmbë, duke shtrembëruar ftyrën në mënyrë të çuditshme, e drejtar nga shtëpia përballë. Gradoj dylbinë dhe mundohem të shoh ftyrat e tyre sa më afër, që të kuptoj se ç'thonë. Teto Fotina vështron me bisht të syrit njëren nga plakat dhe shtëpinë përballë. Papnitur ajo zë faqet e reshkura me duar dhe mundohet t'i këputë (them se u çmend), irregullon shaminë, diçka thotë nëpër dhëmbë, tund kokën me kërcënrim dhe prapë çjerr faqet me thonj.

C'ka ndodhur në shtëpinë e Fitnetit? Përse teto Fotina vështron ashtu? Kthej dylbinë andej. Fitneti, vajza më e bukur e fshatit, me flokë të gjata, të dredhura nga natyra, ri në dritat e qëndis. Ftyrën se ka më ezmere, nuk e dëgjoj më të qeshë si më parë, me atë zërin e saj të çiltër, po rri dhe qëndis ulur në një karrige. Prek herë-herë flokët që i bien mbi gjergjef ku ka vendosur qëndismën, dhe unë nuk kuptoj përsë ftyra e saj nuk është më e qeshur si më parë, nuk vëte as të këndoje në estradë...

- O-gjysh!
- Hëm-m-m! — gjyshi po ndiste çibukun me masat.
- Përse është e inatosur teto Fotina?
- Ku ta di unë bre nipçë? Ndofta s'i del ndonjë puelë... Mos ia ka marrë natën dhelpa?
- Ai më shikon në sy, qesh, heq thellë-thellë çibukun dhe fërkon kurrizin e maçokut që i ka hipur mbi gju.
- O gjysh!
- Hë bre, nip!
- Përse Fitneti e xha Sullos qëndis që në mëngjes gjer në mbrëmje?
- Bën pajën o nip!
- Po Fitneti e bukur pse nuk vete të këndoje më në estradë me rininë, o gjysh?
- Nuk e lejon i ati o nip.
- Po pse, o gjysh?! Ajo këndon aq bukur!... Sa e mirë është! Unë e kam puthur o gjysh Fitnetin e bukur!
- Ja-a-a! Ditke dhe ti nga ato!... Pa i trevo gjyshit, kur e paske puthur?
- Ehe, e putha o gjysh, kur dhamë estradën! He, po unë isha gjoja fëmija i saj...
- Një këndes i kuq dhe lafshëmadh hipi mbi avlli dhe këndoi dy a tri herë radhazi duke rrahur krahët me forcë. Kokën e mbante lart, sytë mbyllur dhe sqepin e hapte si pincë.
- O gjysh! Përse këndesi kur këndon i mban sytë të mbyllur?
- Hëm! Thonë se e di këngën përmendsh, o nip.
- Edhe unë i di këngët përmendsh. Atëherë pse nuk i mbyll sytë kur këndoja?
- Hëm! Di unë!...
- Dylbinë e drejtova nga luadhi ku po kulloste pela kërrë dhe mëzi i bardhë. Katër shokë të mi i afrohen mëzit. Ata mezi duken nga bari i gjatë, fshihen pas lulever-

dhave dhe tërfilit të egër dhe vetëm kokat vozitin sa an-dej-këndeje gjersa e futin mëzin në mes. Unë me mendjen time them që bardhoshi t'ia fillojë prapë vrapit. Kur, për çudi, ai s'lëviz fare nga vendi, madje, i lë fëmijët ta kapnin edhe për kife. Ata shtrijnë nga një dorë përpara. Po hedhin tek a çift. Papritur gjëmoi autokombajna, buçiti kënga e vajzave dhe djemve, pela kërrë ngriti kokën lart, mëzi i bardhë hingëlliu dhe u lëshua në pikë të vraptit në arën e korrur pak më poshtë. Zhurma e autokombajnës dëgjohej deri tek unë e përzier me këngën e vajzave të fshatit. Ah, sikur të isha dhe unë aty! Të rendja me shokët, të mblidhja kallinj, të shkoja të mbushja ujë në burimin e Llëngave... Unë nuk përtoja kurrë, kurrë nuk përtoja, kur më dërgonin me stomnën për të mbushur ujë! Do të shkoja deri larg të gjeja edhe kumbulla me lëng dhe t'ia çoja kombajnerit... Do t'i jepja edhe Fitnetit dhe ajo do të më fërkonte kaçurrelat me pëllëmbën e saj të vogël duke më thënë në vesh:» «Shko na sill ca të tjerë!»

— O gjysh! Sikur t'ia hipësh bardhoshit, atij mëzit marroz që na theu stomnën tek lëmenjtë, të hedh o gjysh?

— Hëm! Të hedh që ç'ke me të dhe të bën copë-copë!

Por mëzi tanë qe zhdukur nga sytë e mi. Ktheva dylbinë nga porta e teto Fotinës. Aty tanë kishin mbetur vetëm tri plaka që po kuvendonin kokë më kokë, duke vështruar rrith e rrrotull se mos u qe afruar njeri dhe i dëgjonte se ç'thoshin. Teto Fotina akoma po tregonte diçka, duke vështruar për nga shtëpia e Fitnetit. Xha Sulua kaloi pranë tyre. Plakat e shoqëruan me sy gjersa ai humbi tek kthesa e rrugës, duke lëvizur kokën secila më vete, me sytë gjysmë të mbyllur, sikur donin të thoshin: «Ah, ç'e turpëroi bukuroshja! Ia hapi syrin e ëma, ia hapi sa!...»

— O gjysh! Përse teto Fotina çaplon sytë ashtu? Ajo po thotë se Fitneti e bukur e paska syrin të hapur...

— Vërtet o nip, — ma ktheu gjyshi, duke u mbushur me frysë. — Fitneti vërtet e ka syrin të hapur dhe e bëri me turp të atin...

— Jo — jo — jo! Gjysh! — thirra, duke m'u çjerrë gurmazi. — Fitneti të dy sytë i ka njëlloj! Unë ia kam parë mirë! Dhe ajo teto Fotina... Ilafazania e dreqit, s'di se çfarë të thotë më parë për të!.. Gjysho! Ç'është kjo taksi që po vjen nga rruga jonë?

— Vjen të marrë Fitneten o nip!

— Kush do ta marrë o gjysh?

— Një babaçko nga qyteti, — tha gjyshi.

«Babaçko! — qesha me vete. — Kaq plak është, sa gjyshi ynë?» Ktheva dylbinë nga dritarja ku ishte Fitneti. Ajo tani ishte çuar nga karrigia dhe doli në dritare. Është përskuqur në fytyrë.

«I vjen turp që do të martohet me atë «babaçkon» nga qyteti,» — mendoj dhe më vjen keq për të.

Taksia qëndroi. Që andej dolën disa burra të veshur mirë, i shtrëngonin dorën babait të Fitnetit, tundnin kokën dhe thoshin: «Të na trashëgohen!» Unë fillova të qesh. Mënyra si e tundnin kokën ata krushq kishte diçka të ngjashme me atë tundjen e kokës së kuajve, kur i zë vapa.

Ktheva dylbinë përsëri nga dritarja. Hë, çfarë po bën ashtu Fitneti? Përse e tund shaminë që qëndiste sikur po hedh valle? Po kur pa dashje drejtova dylbinë andej nga arat ku po korre autokombajna grurë, pashë se dhe andej po tundeshin në ajër shumë shami, lloj-lloj ngjyrash.

Fitneti tani e uli shaminë, vështroi nëpër dhomë dhe, sa hap e mbyll sytë, hipi në dritare dhe u hodh që andej në kopështin tonë.

— O gjysh! O gjysh! Eja pak dhe shiko!

Gjyshi la çibukun mbi tavolinë dhe erdhi tek dritarja, rëndë-rëndë si plak që ishte, duke më marrë dylbitë nga duart.

— Ku të shikoj bre nip?

— Tek porta e Fitnetit, o gjysh!

— Ja-a-a! Paskan ardhur krushqit, a? Qenkan go-xha të ardhur... Po atë dhëndrin ku e kanë xhanëm?

— Oho, gjysh, shiko në obornin tonë!

— Oh, iku, iku, e turpëroi të atin! — thirri gjyshi dhe lëshoi dylbinë mbi dyshek. Shpejt Beni! Më gjej kë-pucët pa ia tregoj unë asaj të paudhe!

Vështrova për të fundit herë me dylbi. Fitneti kishte dalë nëpër kopështin tonë në kopshtet e kooperati-vës dhe po nxitonte për nga arat ku korrej gruri.

— Ku janë këpucët, more, këpucët! — sokëllinte gjyshi me çibukun në gojë. — Beni, këpucët bre!... Ah, do më ikë e paudha.

Pastaj heshti. Gjyshi u ul në vendin e tij, nxori kulinë, dhe e mbushi çibukun, duke e ngjeshur fort me gish-tin e madh.

— Nipçe... Pa vështro edhe njëherë andej ? Iku Fitneti nga oborri ynë ?

— Iku, gjysh, iku. Ajo tani ka mbërritur në atë arën ku po punon rinia e fshatit.

Tej, në atë arën ku korre grurin autokombajna, vaj-zat janë ulur nën hijen e një kumbulle dhe këndo-jnë...

Me dylbinë time të vjetër shoh sesi Koçi, ai djali që i bie fizarmonikës në estradë e që e kisha parë kushedi sa herë të vinte fshehurazi nën dritaren e Fitnetit, vë bu-zën në gaz dhe vështron Fitnetin e bukur. Fitneti dhe Koçi janë ulur pranë e pranë, kurse gjithë rinia dhe brigada i kanë vënë në mes.

Po të vështroje pa dylbi, ai rreth aty nën hijen e kumbullës, dukej si një lule e bukur...

— O gjysh!

Ktheva kokën. Bastuni nuk ishte prapa derës. Gjyshi kishte dalë.

UNE, DJALI I RRITUR MES PYJEVE

Mua, që isha rritur në pyll, nuk më kishte qëlluar kurrë rasti të më plotësoheshin dy dëshira të çuditshme të një fëmije ëndërrimtar, të cilat gjer atëhere nuk ia kisha treguar njeriu: të kisha një çifte dhe të vrisja një ujkonjë. Kaq keq më ishte futur në mendje kjo dëshirë, sa nuk isha dot i zoti të mendoja për gjë tjetër. Shkaku duhet kërkuar tek gjahtari plak, Sotir Pelivori. Ky ishte rojtar pylli dhe vinte shpesh në stани tonë. Sa herë viinte, e shihja me çiften e gjatë hedhur në sup, torbën prej lëkure në shpinë dhe dy langojtë e tij të kuq lëshuar përpara.

Por një shkak tjetër ishte edhe më i madh:

Që kur isha i vogël, umë krekoresha dhe thosha: «Unë do të bëhem ushtar! Unë do të bëhem kufitar trim!...» Ndër ata që më dëgjonin, kishte edhe ndonjë që më ngacmonte: «Ti mo do të bëhesh kufitar!? Ti ke frikë! Ti s'ke vrarë një lepur, na dashke të vrasësh armikun! Vra një herë një lepur, pa pastaj...»

Këta që më ngacmonin kështu i kisha marrë inat dhe, kur u rrita ca, doja t'u provoja se isha i zoti jo për të vra-

rë një lepur, por edhe një ujkonjë dhe të bindeshin pastaj se edhe armikun, kur ta donte nevoja, do të isha i zoti ta prisja në lule të ballit.

E dinin të gjithë, e dija dhe unë se Sotir Pelivorit i qeshte pérherë fati në gujeti. Thëllëza, mëllenja dhe lepuj kisha kapur dhe unë me çarqe, gracka e leqe, por të gjitha këto nuk më ngushëllonin, se tani, po ta shihje punën hollë-hollë, unë isha rritur, në pranverë i mbushja të katërmbydhjetat dhe nuk kisha më me ç'të mburreasha.

Posa mbaruan mësimet, lashë fshatin dhe u ngjita te babai në mal. Unë shkoja çdo verë në stanin e kooperativës; ndihmoja blegtoret kur kullonin qumështin në bidona, shkoja dhe mbushja ujë, ushqëja qentë ose bridha fare i lirë nëpër pyll. Ma kishte qejfi të ngjitesha përpjete lumit që buronte nga mali, të lahesha në ujin e ftohtë, të hidhesha me vrap pas bregut duke ndjekur ndonjë dhelpër ose duke kërkuar strofkën e saj në shpatin shkëmbor.

Vendosa që, pa vrarë një ujkonjë dhe pa ia zënë të gjallë këlyshët që do t'i shkonin pas, nuk do të zbrisja fare në fshat.

Dhe ja, erdhi rasti që u ndodha ballë për ballë me të. Atë mëngjes po shkoja bregut të lumit. Desha të arrija te vendi që më kishte treguar Sotir Pelivori për të mbledhur një tufë me lule agulice dhe manushaqe. Mali ynë kishte plot nga këto lule, por gjahtari plak m'i pati mburrur shumë ato që kishin mbirë mbi kryet e Burimit të Ftohtë. Kur arrita aty, mbusha duart me lule, i lidha tufë me një fije bari dhe i spërkata me ujin e ftohtë të kroit.

Në këtë kohë ndjeva nga larg një zhurmë. Ktheva kokën dhe pasqë një ujkonjë që po rendte drejt burimit. Hipë mbi shkëmb dhe fillova të ndjek i trembur lëvizjet e egërsirës. Ujkonja më pa dhe qëndroi e kthyer me vësh-

trim nga unë. Ishte e madhe, me gjirin të varur, gjoksin të mbuluar me lesh të bardhë, shpinën të murrme dhe me qime të ndritshme.

Ajo, me veshët ngritur lart, po i afrohej burimit, sytë i ndrisnin, bishti i lëvizte pa pushim, ndërsa nga goja e hapur dukeshin dhëmbët e saj të hollë e të bardhë. Po të isha i rritur dhe i fuqishëm do të rrëmbeja një dru t'i bija. Ose, po të kisha një pushkë, egërsira nuk do të rrinte aq e qetë aty afër meje. S'kisha ç'të bëja! U hoqa mbrapa me kujdes, duke u munduar që të mos i bija në sy që po largohesha. Dola në një monopat dhc u nisa me vrap për në stan. Xha Ganiu, njëri nga barinjtë e stanit, sa më dëgjoi se kisha parë një ujkonjë, rrëmbeu pushkën, hodhi tej atë xhaketën e tij prej leshi, më kapi për krahu dhe më tha që të vrapoja përpara, drejt vendit ku e kisha parë egërsirën. I ramë një shtegu tjetër që të dilnim sa më parë te burimi ku kishte shkuar ujkonja për të pirë ujë. Kur mbërritëm aty me armën peshë në duar, egërsira qe zhdukur.

Nuk lamë vend pa kontrolluar: tumbat e dendura të ahishteve, vrimat e shkëmbinjve se, kush e di, mendonim, ujkonja e lodhur, e rënduar nga uji që kishte pire, mund të ishte fshehur në ndonjë strofkë aty pranë.

— Ama, trim që më qënke dhe ti! — më tha bariu, kur morëm shtegun dhe po ktheheshim në stan.

— Nuk kisha se çfarë t'i bëja, — i thashë.

Bariu tundi kokën, e hodhi armën në sup dhe nxitoi përpara. Nuk më tha asnje fjalë gjatë gjithë rrugës për në stan. Edhe unë nuk desha që ai të fliste. Gjithçka ishte e qartë.

Të nesërmen mora sëpatën dhe shkova përsëri aty ku kisha parë ujkonjën. E kërkova dhe dy ditë më pas, por egërsira s'u duk më afër burimit.

Ujkonjën nuk e pashë më, por kurrë nuk hoqa dorë nga gjurmimi.

Xha Gani u tregoi edhe barinjve të tjerë dhe ata filluan menjëherë nga shakarat.

— Eh, ç'të punuar që ua bëri ajo ujkonja!

— Po si bre, u trembe nga ajo dhe ja dhe vravit për në stan!

— Nuk kisha se me çfarë ta vrisja, — shfajësohesha unë. — Ma lini pushkën ndonjë javë, po nuk e vrava poo!...

— Nuk lejohet të marrësh armë ti, jë akoma i vogël!
— I vogël unë, ë?! Po a e dini ju, sa pikë mora në qitje? — mora zjarr menjëherë. — Shkonit dhë pyesni mësuesin po nuk besuat! Unë dola i pari në qitje!

— Nuk je gjë hiç!... — më tha më në fund bariu më i vjetër dhe u shkeli syrin të tjerëve.

Por unë e kisha kuptuar se ata po bënin shaka më mua.

Babai tundte kokën i menduar dhe mua më dukej sikur më thoshte:

«Fare i papjekur dole këtë radhë. Xheç të dija dhet ty...» Atë natë nuk më zuri gjumi fare nga inati. Vërtitesha në shtratin e vogël shtruar me fier të thatë, mbulloja kokën me pallton e madhe të babait dhe, ashtu në heshtje, fillova të thur plane në mendjen time. Të nesërmen përgatita leqe e çarqe prej teli dhe të gjitha këto pa ia treguar njeriu.

Si ikën kopetë për kullotë, pasi mbusha ujë dhe rrugullova shtretërit, mora çarqet dhe shkova te burimi, aty ku disa ditë më parë kisha parë ujkonjën. Ngrita leqet dhe çarqet nëpër shtigjet që të çonin tek burimi dhe, pasi zura pusi me sëpatën në dorë, prita kushedi sa orë. Papritur u dëgjua një zhurmë në fletët e thata të pyllit. Shtrëngova sëpatën dhe zemra filloi të më rrahë me fuqi. Më në

fund erdhi çasti që po prisja prej aq kohësh... Ah, jo! Ishte gjahtari plak Sotir Pelivori.

— Çfarë po bën këtu?, — më pyeti ai dhe hoqi nga koka kapelën e tij prej lëkure.

Unë ia tregova të gjitha. Në fund, pasi mbarova së tre-guari, ai qeshi. Qeshi fare pa zë, ashtu siç qeshin zakonisht pleqtë, duke zbardhur ato dhëmbët e rrallë, duke ndjellë hundët dhe gjithë duke kruar kokën e tij tullace.

— Me gjithëmend e ke?

— Po, xhaxhi Sotir, kam kohë që po mundohem përkëtë gjë...

— Të vjen inat që nuk e vrave egërsirën?

— Më vjen sa unë e di, — i thashë me gjysmë zëri, — po ti po të duash, më ndihmo ta vras atë ujkonjën.

Sotir Pelivori qe plak i çuditshëm. Kishte një palë mu-staqe të gjata, opinga të lehta prej lëkure kau, çorapë leshi dhe në brez një vezme ku fuste fishekët e çiftes së tij dy-grykëshe. Kur vinte në stan dhe më shihte mua aty, nuk di pse ia shkrepte gazit pa arësy. Edhe sot ai filloi të qeshë, duke më vështruar me bisht të syrit.

Ai qe plak dhe nuk mund të merrej me tekat e mia, por sidoqoftë, ai qe gjahtar dhe ma kuptoi dëshirën.

Sotir Pelivori ishte i vetmi që e dinte dëshirën time të fshehtë që po më mundonte prej disa muajsh.

— A nuk më tha sa e madhe qe ajo ujkonja që pëti? — më pyeti ai pas pak.

Unë i tregova se si qe.

Ai tundi kokën dhe diçka tha nëpër dhëmbë.

— Pse, e ke parë ndonjëherë ti atë ujkonjë? — e pyeta.

— Aha! Ta kisha parë unë, zor se më shpëtonte!... Po ti mos u bëj merak o bir. Unë plaku nuk të lë të mundohesh kështu, do të të ndihmoj me tërë fuqinë që më ka mbetur tanë në pleqëri. Po dhe ti ama nuk duhet të

më turpërosh. Di të shënosh me pushkë? — më pyeti papritur dhe më vështroi me ata sytë e tij të vegjël dhe të mprehtë.

— Si ore nuk di të qëlloj! Aty në shkollë në...

— Ti duhet të dish të qëllosh mirë me pushkë, — më tha plaku, duke nxjerrë nga çanta e shpinës pagurin pér ta mbushur me ujë. — Edhe babai yt di të qëllojë mirë me pushkë. Ti nuk duhet ta turpërosh babanë tënd. Pastaj, si piu ujë, fshiu mustaqet me mëngën e xhaketës, hodhi çiften në sup dhe vazhdoi: — Tani do të iki, po ti mos u mërzit gjersa të vij unë. Do të të marr dhe do të shkojmë ta vrasim ujkonjën. Do t'ia gjej patjetër strof-kën. Mos më thënçin Sotir Pelivori, po nuk ia gjeta shtegun!

Dhe kështu ne u ndamë: ai iku përpjetë malit ku kishte punë, ndërsa unë u ktheva kokulur dhe i menduar në stan. Pas bisedës që kisha bërë me gjahtarin plak, e ndieja veten më të qetë dhe fjalët e tij më kishin ngushëlluar.

Kalonin ditët dhe Sotir Pelivori ende nuk po dukej nga stani. Në mbrëmje, kur mblidheshin barinjtë pranë zjarrit aty te vatha e dhenve, ndonjëri zinte në gojë gjahtarin plak. Unë na-a i bëja veshët! Barinjtë thoshin se plaku ishte i shqetësuar, gjithë ditën rendte pyjeve dhe gërxheve dhe nuk kishte të lodhur. Kur e pyesnin përsë kontrollonte ashtu nëpër shkëmbinj dhe kaçube, plaku vinte buzën në gaz dhe nuk u përgjigjej. Tek dëgjoja barinjtë që thoshin kështu, më bëhej qejfi mal, dëshira ime e fshehtë më ndizej më shumë dhe ndieja një farë qetësie në vetvete se gjahtari plak nuk ia kishte treguar njeriu këtë të fshehtë dhe se ai po mundohej dhe po ropa-tej pér mua.

Edhe unë nuk ndenja duarkryq. Shkoja në vendin ku i mbante babai dhentë mërzim dhe stërvitesha me

zell tē madh pēr tē marrē vijēn e shēnjimit me atē pu-shkēn e rēndē gjermane qē im atē nuk e kishte hequr nga supi prej kushedi sa vjetesh.

Më nē fund fillova tē shqetësohesha përsëri. Sotir Pelivori nuk po vinte ende nē stan qē tē më merrte sipas fjalës. Ku shkonte ai dhe pse nuk po vinte ndonjë ditë nē stan? Pse barinjtë thanë se nuk e kishin takuar plakun dy ditë me radhë? Mos është sëmurur gjë dhe ne nuk e dimë? Apo ka harruar premtimin qē më pat dhë-në mua te burimi?

Ai erdhi fare papritur një mëngjes. Më gjeti tē menduar brenda nē kasolle. Unë, porsa e pashë qē nderi kokën, brofa menjëherë nē këmbë dhe, kur vura re qē po qeshte ashtu siç e kish zakon, nuk m'u durua dhe thashë vetëm:

- E?
- E gjeta.
- E gjete?
- E gjeta!

U çudita kur pashë se nē sup ai kishte dhe një pu-shkë.

- Shpejt, mos u vono, o trim!
- Unë kam dhjetë ditë qē po pres! — thashë.
- Pra, je gati? Mirë atëherë, eja, ndiqmë! Ah! qerrata, qerrata! Hë de shpejt! Pra dhe ti ke pritur?... Gjë e mirë kjo, më bëhet qejfi! I ke ngjarë tamam tyt'eti!... Më bëhet qejfi!...

Ai fliste me zë tē hollë, tek ecte përpara me hap tē gjatë dhe tē shpejtë nē monopatin e rrahur përmes pyllit.

I ramë pllajës së malit tej e ndanë, kaluam përmes livadheve, nëpër shkëmbinjtë e thepisur, pimë ujë nē dy burime; plaku nxitonte përpara pa u lodhur. Njëherë qëndruam te një krua me ujë tē ftohtë. Më ishte tharë goja, por nga padurimi as qē më shkonte ndër mend tē fresko-

hesha ndopak. Gjahtari plak hoqi kapelen, i hodhi një grusht ujë kokës së tij tullace, pastaj u ul mbi një gur dhe ndezi një oigare.

Plaku qeshte nën buzë me heshtjen dhe padurimin tim.

*

*

*

Ne kishim gjithë ditën që po çanim pyjet, kur më në fund plaku më tha që të mos flisja e të mos bëja asnje zhurmë.

Të them të drejtën kisha filluar të mërzitesha. Kot që i isha qepur këtij plaku. Mbase ai ka pasur ndonjë punë... Pse kështu vritet ujkonja?!

Befas ndjeva dorën e tij mbi sup dhe u drodha.

— Ujkonja! Shtrihu!

— Ku është?

— Aty poshtë.

Gjahtari plak tregoi nga pylli i dendur.

— Nuk po e shoh, — i thashë.

— As unë nuk e kam parë akoma, — tha gjahtari rëndë-rëndë. — Duhet të presim pak sa të dalë nga strofka.

— Ku e di ti?

— I dëgjova hungurimën.

— E qëllon dot që këtu?

— Unë e qëlloj që ç'ke me të, por qaj hallin tënd...

— Do ta qëlloj, mos u bëj merak!

Ia thashë këto fjalë me bindje të plotë. Tani që gjah-tari plak më kishte lëshuar në dorë pushkën e tij, e ndieja veten më të sigurt. Pastaj më shkoi ndër mend: po sikur ai ta shihte përpëra meje dhe unë të mos e vrisja vetë ujkonjën?!

U shtrimë mbi barin e livadhit dhe bëmë gati armët. Më dukej sikur do të shkonte gjithçka si jo më mirë dhe asnjëherë nuk e kisha ndier veten aq të sigurt sa atë çast.

— Shiko drejt atij shkëmbi! — më tha plaku me të rreptë, pasi u sigurua se unë e mbusha armën në rregull, — dhe më tregoi me kokë vendin ku duhej ta zija pritën.

E çara e shkëmbit nxinte. Degët e aheve mezi lëviznin. Ato çaste nuk ndihej asnje fije erë. Klithi një mëllënjë e zezë. Zogu fluturoi mbi kokat tona dhe humbi diku në pyll.

— Hë, ku është? — nuk m'u durua.

— Sh-ë-ë-t! Mos folë se na ikën!

U dëgjua një hungërimë e mbytur. Pak më vonë e çara e shkëmbit u zu dhe që andej doli ujkonja. Egërsira vështroi rrëth e rrotull duke u kthyer me gjithë trupin. U shtri barkas dhe më humbi nga sytë. I dukej vetëm bishti që valëvitej lart, mbi barin e livadhit. Pastaj egërsira angulliu lehtë, u ngrit në bisht dhe filloj të lëpihet. Atë çast shtrëngova pushkën pas supit dhe e mora në shenjë. Qe një punë e thjeshtë për atë çast aq të shumëpritur.

— Shtjerë! ç'pret më?! — pëshpëriti gjahtari i shqetësuar. «Ja, ja, ujkonja që mbyti dy delet e kopesë së babait. Eh, shtrigë mali, nuk më shpëton dot!»

— Bjeri, bre!

Ujkonja ktheu kokën andej nga pëshpëristë Sotir Pelivori. Veshët i ngriti akoma më shumë, duke i drejtuar përpara. Mora shenjë gjoksin e saj të gjerë, shtrëngova dhëmbët dhe tërhoqa këmbëzën e pushkës ngadalë.

Megjithëse isha shtrirë, pashë egërsirën që kërceu lart, u rrotullua në ajër dhe ra në kurriz.

— Bjeri, bjeri, ja ku e paska dhe këlyshin!

Ujku i vogël doli nga strofka dhe mbajti vesh. Edhe ai vështroi nga ne, duke kapsallitur sytë e vegjël si rruaza. Unë sakaq kisha hequr shulin prapa dhe kisha mbu-

shur përsëri armën. Mbas së shtënës që bëra unë, buçiti dhe ajo e çiftes.

Ktheva kokën. Gjahtari plak nxori nga vezmja përsëri dy fishekë dhe e mbushi armën.

Shikonte nga unë dhe qeshte me një kënaqësi të madhe. Qeshte dhe fliste pa pushim.

Ai më përgëzonte:

— Të lumtë, të lumtë, o i biri i Mihalit!

Mirëpo unë, nga që isha ende i turbulluar, nuk po e kuptoja mirë ç'më thoshte dhe pyesja me vete gjithë merak:

— A i vrava të dy? A do të më tallin tani se nuk jam i zoti të vras qoftë dhe një lepur?

DUKE KÉRKUAR MANARIN

Gjithë mbasditen kërkova manarin tim. Renda përmes fushave, çava korijet me lisa sipër fshatit, laga këmbët kushedi sa herë nëpër moçalishtet e vogla, m'u rëndua banku nga uji i burimeve, por dashulin tim manar nuk e gjeta dot. Një lëmsh i madh inati më ishte mbledhur në grykë. Duke rendur gëlltitesha, por prapë se prapë lëmshi nevrik i mbledhur në grykën e një fëmije të shkollës fillore, nuk zbriste poshtë... Këmisha m'u gris pas ferrave dhe kulumbrive, sandalet m'u këputën në barin e gjatë dhe kopsat e pantallonave po më këputeshin një e nga një tek ngecja pas degëve të shkurreve. Me njérën dorë duke mbajtur pantallonat që të mos më binin poshtë, dhe me tjetrën duke hapur degët e shelgjishtave anës lumit, po ngjitesha përpjetë bregut. Uji i lumit bënte një zhurmë të madhe. Duke dëgjuar këtë zhurmë, që nuk po e duroja dot, më shkrepi papritur të thërras:

— Manar! Manar!

Por oshëtima e ujit i myti fjälët «manar, manar».

— Eh, o manar! Eh, o briturjelë, ç'ma ke punuar sot! Prit, pa ta tregoj unë ty! Po të lashë edhe njëherë vetëm, poo!..

Vazhdova tē ecja dhe tani zhurma e lumit kishte mbe-tur pas. Gurgullima e tij tani vinte si e zbutur. Nga lodhja u shtriva mbi barin e njomë tē bregut, nën hijen e një shelgu. Sytë më ishin ngjitur nga djersa dhe lodhja. Me vështrim tē tretur në qiellin e përflakur nga dielli që po i afrohej malit, po sillja ndërmend tē sharat e nënës pér këmishën e grisur, zërin e fortë tē babait pér humbjen e manarit dhe tē sandaleve në barin e livadheve... Po Palushi? Ah, vëllaçkoja, nuk do tē më shante fare! Ai tani është në shkollë, por ama, po tē ishte këtu në fshat dhe tē më shihte pa sandale dhe me këmishë tē grisur, do tē më kapte pér dore, do tē më conte në dyqan dhe do tē dilja që andej i veshur me bluzë vija-vija si tē sportistëve, me një palë këpucë tē reja tē lehta... Befas, këto ëndërrime anës lumit pér këmishë dhe këpucë tē reja, m'i preu një zë i hollë vajze.

— Mësuesja! — mend thirra.

U ngjesha mirë e mirë pas barit, futa kokën në shelgjishtat e dendur dhe prita me ankth. Atë çast m'u bë sikur dëgjova: «çohu, Artan! Përse je fshehur këtu?» Ktheva menjëherë kokën. Nuk qe asnjeri. Vetëm degët e holla tē shelgishtave fëshfërinin nga flladi i lehtë që fryn verës çdo mbrëmje pas bregut tē lumit.

Bari i thatë aty pranë meje kërciti lehtë. Unë, i trembur, u bëra njësh me dheun. Hunda më preku në një folë milingonash.

— Ulemi këtu?...

«Ajo qenka me tē vërtetë — mendova, dhe bëra tē ngre pak kryet, që tē shihja më mirë.

— Ku tē duash. ti, Luizë.

Po, ai qe. Ky zë ishte i Nasi marangozit. Si tē bëja? Të ikja? Po sikur tē më shihnin? Ç'do tē mendonte mësuesja pér mua?...

Ngrita kokën me kujdes. Zemra më rrihte aq fort, sa

mezi merrja frymë. Mësuesja ishte ulur afër tij. Flokët e gjatë dhe të butë si mëndafshi i kishte krehur ndryshe nga herët e tjera. Nasi nuk ia ndante sytë. Ashtu siç qe i shtrirë në bërryla, flokëkaçurrel, me mustaqe të holla që i shkonin aq shumë, dukej më i bukur dhe serioz. Herë pas here e shkelte syrin e djathtë dhe vinte buzën në gaz. Atij patjetër që i binte dielli i kuq i perëndimit në ftyrë, ndryshe përsë do ta shkelte syrin ashtu?

— Luiza!

Mësuesja vështroi nga ai. Sytë e saj të zinj vezulluan. Ai i hodhi duart papritur në bel dhe e puthi.

Ngjesha kokën pas barit. Veshët më buçisnin. Kisha frikë t'i hapja sytë. U ktheva në shpinë. Mbi kokë pashë majën e plepit që lëkundej. Edhe mendja m'u soll sipas ritmit të tij. Kur vështrova andej pas pak, mësuesja dukej e menduar dhe vështrimin e kishte mbërthyer mbi rrjedhën e lumit. Nasi buzëqeshte dhe vërtiste një luleshqerë nëpër duar.

— Përsë mendohesh, — e pyeti ai.

— Mirë bëre që fole, — ia ktheu mësuesja, duke mbajtur duart mbi gjunjë, — kisha frikë se për pak do të më zinte gjumi.

— Çfarë të tha mbrëmë babai?

— Ato që më thotë përherë.

— Po ti çfarë i thua, kur ai ngul këmbë në të tijën?

— Edhe unë ngul këmbë në timen.

Nasi përsëri vuri buzën në gaz. Nderi dorën mbi mezhë dhe këputi një luleshqerë tjetër.

— Përsë qesh? — ia ktheu mësuesja. — Të duket e lehtë kjo që po ndodh me mua?

— Ti nuk duhet të trembesh nga asgjë.

— Nuk jam kot mësuese...

Nasi filloj të qeshë dhe pas tij qeshi dhe mësuesja. Unë ende nuk po kuptoja se ç'kishte këtu për të qeshur.

Isha i vogël dhe atëherë nuk dija shumë gjëra.

— I tregove për mua? — e pyeti Nasi duke prerë të qeshurën.

— Babait nuk i kam thënë gjë, po i tregova mamasë. Atij se kush i ka thënë. Të dielën mbrëma kishte ardhur nën dritaren e vatrés së kulturës, ku po bëhej mbrëmja e vallëzimit dhe na kishte parë kur ne kishim vallëzuar bashkë. Këto m'i tregoi mamaja.

— Po mamaja më do mua që...

— Kur i tregova mamasë për ty, ajo më tregoi për planet e babait...

— Ti, a më do mua?

Mësuesja ngriti kokën dhe e vështroi e çuditur.

— Ehu dhe ti, — ia ktheu ajo, — atëherë përse pranova të vij sot në takim?!

Mësuesja përgjigjej kur e pyeste ai dhe shikimin nuk e hiqte nga rrjedha e lumi. E merrja me mend se ç'shihte ajo: një zambak varej mbi sipërfaqen e ujit dhe valët e lehta e shtynin përpara, mend po e këputnin, por zambaku shkëputej befas nga valët dhe lëkundej në vendin e mëparshëm. Mbi petalet e verdha të një luleje tjetër diçka vezulloi...

— Gjarpëri! — klithi mësuesja dhe u bë njësh më djaloshin. — Vraje Nasi, vraje se mos na fshihet nëpër shelgishtat! U hodha përpjetë i trembur! Pantallonat për pak më ranë poshtë. Gjarpëri po vinte drejt meje me kokën të ngritur lart, sytë i ndritnin si rruaza xhami dhe kishte nxjerrë gjuhën e hollë jashtë, ashtu siç bëjnë gjarpërinjtë kur janë në rrezik.

— Artan!

Mësuesja rendi drejt meje dhe më kapi për krahu. Nasi po kërkonte gurë për të vrarë gjarpërin.

Unë u pengova në një shkop, po nuk rashë. U ula, rrëmbeva shkopin në duar, dhe u bëra gati të godas.

— Prit! Lermë ta vrás! — thirra dhe ndjeva se pain-tallonat po më vareshin ngadalë poshtë. Lëshova me têr-sëllëm shkopin mbi kokën e zvarranikut që u mblohd menjëherë lëmsh, i plagosur pér vdekje. Atë çast, ndjeva dorën e Nasit që më mbërtheu pérkrahu. Bëra tê shkëputësha nga ajo dorë e fuqishme, por ishte e kotë.

Mësuesja po më vështronë me sy tê trembur. Asaj kurrë nuk i kishte shkuar ndër mend se nxënësi i saj një ditë... Më zuri pér dore. Nuk kishte fare fuqi. I dridheshin duart.

- Artan, çfarë bëje këtu? — më pyeti mësuesja.
- Kërkoja manarin, mësuese...
- Cilin manar?
- Dashulin tim!

— Vërtet? — ia bëri ajo dhe u kthjellua menjëherë. I bëni shenjë me dorë Nasit dhe tê dy shkuam te mezhda afér lumit. Aty më uli pranë saj dhe diçka u mat tê më thoshte, por nuk foli. Pastaj më hodhi dorën në qafë. Më erdhi inat pér këtë. Pse ç'isha unë? I vogël që ajo tê më hidhët dorën në qafë dhe tê më merrte ashtu me tê mirë? Si lliri që ka qejf tê rrijë në prehrin e nënës? A nuk isha unë ai që vrava me një tê goditur gjarprin e tmerrshëm?

Bëra tê çohem, por ajo më kishte shtrënguar pas kraharonit tê saj që ulej dhe ngríhej pa pushim.

Nasi më vështronë me bisht tê syrit dhe kishte vënë buzën në gaz. Këputi një luleshqerë dhe e hodhi drejt meje. Lulja më qëndroi mbi kokë. Ai qeshi nën mustaqet e holla.

- Artan, — më foli mësuesja në vesh, — do tê më thuash tê vërtetën: Manarin kërkoje vërtet?
- Manarin mësuese...
- Pse ke manar ti, Artan?
- Si nuk kam? Harrove kur një ditë nuk m'u nda gjer brenda në klasë? Manari hyri nën një bankë dhe nuk

donte të dilte që andej... Kur ju hytë në klasë, unë prisja që të më qortonit; kurse ju qeshët... Pastaj... Pastaj u mblozhëm rrëth tij, qeshnim, e ngacmonim, e kapnim për briri...

— Kur do ta therrni këtë dash? — më pyeti Nasi.

— Për dasmën e Palushit — o,

— Pse ka nuse Pali juaj?

— Ka një me flokë të verdhë.

— Ku e di ti?

— Ua! Ku e di -o! Po mua Pali ma tregoi njëherë kur vajta në Tiranë. Nusja e Palit më bleu akullore, një laps dhe një abetare!

— Mirë, mirë, — më tha Nasi, — po tani do të na tregosh të vërtetën: çfarë pe kur ishe fshehur në shelgishtat?

Unë, që pak më parë m'u zgjidh gjuha dhe fola mjaft, tani ula kokën dhe heshta. Çfarë t'i thosha Nasit? Si të tregoja... dhe ku se! Në sy të mësueses sime të dashur?!

— Perderisa hesht, — tha Nasi, — do të thotë se i paske parë të gjitha...

Mësuesja psherëtiu. Sa keq më erdhi për mësuesen. Kur shihja fytyrën e saj të pikëlluar, më dukej sikur nga faji im, nga marrëzia e një nxënësi të saj...

— Nasi, përse po qesh?

Ai tundi kokën kaçurrele dhe vazhdoi të qeshë, duke u tundur i téri. Ata të dy tani filluan të bisedojnë pa u druajtur nga unë. Kur pashë diellin që po na e bënte me sy aty mbi majën e malit Moravë, u kujtova për manarin dhe u ngrita. Nasi, duke qeshur, më rregulloi pantallonat dhe më tha:

— Nuk do t'i tregosh njeriu, hë?

E vështrova drejt në sy, duke kafshuar buzën, dhe po mendohesha...

Kalova përmes oborrit të shtëpisë sonë pa u ndier; por kur dëgjova se po bisedonin brenda, nuk ma mbajti të hyja. Anës murit të shtëpisë Pali kishte mbjellë lule dhe ato ishin zgjatur deri te dritarja. Porsa dëgjova hapa në korridor, u ngjesha pas murit nën dritare, duke u fshehur në mes të luleve.

«Ja, doli dhe nëna, — mendova. — Ajo do ta marrë vesh menjëherë punën e këmishës.»

Nëna kaloi nëpër korridor, diçka tringëlliu atë kohë në duart e saj, pastaj hyri përsëri në dhomë ku dëgjova zërin e babait.

— Sillna shpejt dhe shishen e rakisë! — tha babai.
— Bëj ç'të bësh dhe për ndonjë meze... Hë, se xha Gjergua është i kupës de!

«Bobo, babai i mësueses!, — mendova i trembur, kur u shqiptua emri i tij. — Përse ka ardhur vallë? Mos ka ardhur për t'i thënë babait që më zuri duke ngrënë mana në pemëtore? Apo e ka kapur manarin në ndonjë arë të mbjellë? Eh, o manar, manar, ç'më gjeti mua sot me ty!»

Isha mbledhur sa një grusht aty prapa luleve dhe tani po prisja me zemër të ngrirë se ç'do të thoshin dy burrat, si do të më shante babai përfajin që kisha bërë.

U ngrita në majë të gishtave dhe vështrova nëpër xhamin e dritäres se ç'bëhej brenda.

Xha Gjergoja ishte rojtar i fushave dhe, duke e vështruar që rrinte aq i mërzitur përpëra babait, mendova se atij patjetër i vinte zor të tregonte përfajin...

Hyri dhe nëna dhe solli rakinë. Im atë mbushi gotat. Xha Gjergoja ngriti kokën. U vështruan në sy me tim atë.

— Të na trashëgojen!, — uroi im atë. — Djalim e pres të më vijë këto ditë.

Xha Gjergoja e hodhi gotën me fund, fshiu buzët, u rehatua më mirë në karrige dhe psherëtiu.

— Kam frikë se nuk do të bëhem i dot krushq, — tha ai, — dhe ndezi një cigare.

— Si?... Çfarë po thua kështu? Je në vete? Jemi burra, a po ç'jemi?!

Xha Gjergoja psherëtiu prapë dhe tundi kokën i menduar. Psherëtiu dhe im atë. Ato ishin dy psherëtima në një kohë që tregonin një hall të madh.

— Të kujtohet? Të kujtohet këtu e njëzet e tre vjet më parë? — tha babai, duke ngritur lart ato vetullat e tij kaleshe. — Erdhi Simoja, ndjesë pastë, ne po prisnim dru në mal, erdhi dhe, pa u hedhur mirë nga kali, thirri: «Sihariq! Çupë dhe djalë në një ditë dhe në një orë!» Dhe ne shtrënguam duart që aty; pa pyetur fare se ç'kisha unë dhe ç'kishe ti. «Të na trashëgohen!» thamë me një gojë. Po tani?... Epo, — thashë, djali më mbaron sivjet, del veteriner, çupa e mirë është, mësuese, do të shkojnë përbukuri...

— More, po unë nuk ta shava djalin! Puna është se sime bije i është vardisur keq ai djall mustaqe... — xha Gjergoja këtu heshti, tundi kokën i nevrikosur dhe shtoi: — Ke parë ti? I vardiset djali pa gjë të keq çupës, pa i kishte vajtur dhe nën dritaren e shkollës: ai me sharrë dhe sqepar në dorë, ime bijë pështetur në parvaz të dritares dhe qesh e qesh pa pikë turpi... Argaliset biri i botës pa gjë të keq m'u në mes të fshatit! Ja ku po ta them se ai mustaqedjalli është kokëkrisur! Më duket se duhen... Puna është se dhe vajzën nuk e bind dot që nuk e bind! Nejse... unë sonte do ta përmbledh edhe njëherë çupën dhe do ta pyes se si e ka punën... Sot me të rinjtë nuk bëhet shaka për këto punë!

Të dy heshtën. Në dhomë u vendos qetësia. Ashtu siç isha varur pas hekurave të dritares, fillova të shqetë-

sohem dhe më erdhi të thërras me sa më hanin mushkëritë:

«Ehe, vëllaçkoja, o baba, e ka gjetur nusen me kohë! Sa e mirë qe ajo! Ajo vjet më bleu akullore, laps dhe abetare. Pastaj dolëm shëtitje. Më morën në mes. Ata të dy më kishin kapur për dore, qeshnin dhe bënин shaka, shtrëngonin dorën time në një kohë, dhe kur u ulëm në një stol të lulishtes, nuk m'u durua dhe i thashë Palushit: «Këtë ta marrësh për nuse!» Ata të dy qeshën me të madhe, ndërsa unë shihja punën time: shfletoja abetaren dhe lëpija me gjuhë akulloren. Ehe, kot po rrini pa gjumë! Kot po e vrisni mendjen. Vëllaçkoja e ka gjetur vetë nusen!»

Unë nuk e di se sa ndenjën babai dhe xha Gjergoja ashtu duke biseduar. U ngjita pa zhurmë nëpër shkallët që të çonin lart në dhomat e tjera të shtëpisë, u futa në shtrat, mbulova kokën dhe gjumi më erdhi menjëherë,

Në mëngjes, kur isha ngopur me gjumë, dëgjoj blegërimën e manarit dhe nëna hyri në dhomë duke thirrur me të madhe:

— Ah, tersi i Pojanit, na ke lënë gjithë natën pa gjumë! Ku nuk të kërkuam. Kurse ti, pa çarë kokën për prindërit, vjen e futesh fshehurazi në krevat!... Shpejt, të shkoi ora për në shkollë!

Atë ditë mësuesja ishte shumë e shqetësuar. Rrinte ulur në katedër dhe nuk lëvizte nëpër klasë si ditët e tjera. Bile, atë ditë ajo harroi të na kontrollonte dhe detyrat. Fati im, se do ta kisha zënë atë ditë katrën për hunde në aritmetikë.

Në një çast më vështroi mua. Sytë e saj ishin të përskuqur. Patjetër që ajo nuk do kishte fjetur gjithë natën. E vështroja fshehurazi dhe mendoja se unë isha i vetmi midis shokëve që dija shkakun e shqetësimit të saj.

Askush nuk bënte zhurmë. Vetëm një mizë përplasej pas xhamit të dritäres.

Papritur, jashtë u dëgjua boria e një automobili. Ktheva kokën nga dritarja. Te sheshi përpara shkollës kishte qëndruar një makinë. U hap dera dhe që andej doli im vëlla, Palushi, pastaj ajo... E bukur, flokëverdhë, u kthyte dhe vështroi shkollën tonë.

— Pali!

Vëllaçkoja ngriti dorën lart. Në dritaren tjetër kish-te dalë dhe mësuesja. Palushi lëshoi valixhen përtokë dhe foli:

— Si je Liza!

— Mirë, Pali, Ti si ke kaluar? — tha mësuesja.

— Ja, mbaruam mësimet dhe erdhëm... Vjollca! — i tha Pali nuses që kishte prurë me vete dhe i tregoi Lizën me dorë.

Mësuesja u nder përmbi parvazin e dritäres dhe i shtrëngoi dorën Palit dhe nuses së tij flokëverdhë.

— Të trashëgoheni! — i uroi mësuesja me gëzim.

— Faleminderit, Liza! — tha Pali dhe pastaj, duke më vështruar mua, shtoi: — Mund ta lejosh pak Artanin të vijë të na ndihmojë? Kemi plot çanta.

Mësuesja më dha leje të shkoja.

Vjollca më rrëmbeu ndër duar e më shtrëngoi fort. Pas saj Pali, me një mallëngjim të veçantë këtë radhë.

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
BIKU	3
SHTËPIA E PËRGJUMUR	14
KOMBAJNERI	23
I BIRI	30
ZJARRET E NGRICAVE	38
DASMA E ÇIFTIT SYKALTËR	49
FITNETJA	64
UNË, DJALI I RRITUR MES PYJEVE	70
DUKE KËRKAUAR MANARIN	80

Et-kosovarët - Et-kosova - Et-kosova - Et-kosova - Et-kosova - Et-kosova
et-kosova - et-kosova - et-kosova - et-kosova - et-kosova - et-kosova
et-kosova - et-kosova - et-kosova - et-kosova - et-kosova - et-kosova